VENDIM
Nr. 581, datë 6.10.2021

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË KONTRIBUTIT KOMBËTAR TË PËRCAKTUAR

(Ndryshuar me VKM nr. 646, datë 27.8.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit, që përcakton Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (NDC) për arritjen e objektivit global të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), me qëllim mbajtjen e temperaturave të ngrohjes globale nën 2°C, duke kufizuar rrezikun e ardhshëm e kostot e përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të dorëzojë dokumentin, që përcakton Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (NDC), në Sekretariatin e Konventës.
3. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për energjinë, ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

(Ndryshuar teksti me VKM nr. 646, datë 27.8.2026)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

KONTRIBUTI KOMBËTAR I PËRCAKTUAR I SHQIPËRISË

3.0

Nëntor, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e përmbajtjes
Akronime
Lista e tabelave
Lista e figurave
1. Përmbledhje
2. Përmbledhje e zhvillimeve procedurale
3. Rrethanat kombëtare
4. Zbutja
4.1 Objektivi për zbutjen në KKP 3.0
4.2 Krahasimi me objektivin e mëparshëm të KKP-së
4.3 Projeksioni i shkarkimeve dhe përthithjeve të GES-ve
4.4 Veprimet për zbutjen
4.5 Financimi i përllogaritur për masat zbutëse
5. Përshtatja
5.1 Sektorët prioritarë – Konteksti
5.1.1 Bujqësia
5.1.2 Pylltaria dhe kullotat
5.1.3 Turizmi
5.1.4 Energjia
5.1.5 Transporti
5.1.6 Zhvillimi urban
5.2 Ndryshueshmëria e klimës dhe ndryshimet klimatike
5.2.1 Temperatura
5.2.2 Reshjet
5.2.3 Rritja e nivelit të detit
5.3 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria nga ndryshimet klimatike
5.3.1. Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e bujqësisë
5.3.2 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e pylltarisë dhe kullotave
5.3.3 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e turizmit
5.3.4 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e energjisë
5.3.5 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e transportit
5.3.6 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e zhvillimit urban
5.4 Masat e përshtatjes
6. Informacion për të lehtësuar qartësinë, transparencën dhe kuptimin e dokumentit të përditësuar të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar të Shqipërisë, për periudhën 2025–2035
7. Referenca

AKRONIME

Akronimi	**Emërtimi i plotë**
ZAE	Zonë agro-ekologjike

Akronimi	Emërtimi i plotë
RGjV (RV6)	Raporti i gjashtë i vlerësimit (i PNNK-së, 2022)
BaU	Punë si zakonisht (skenar)
BTR	Raporti dyvjeçar i transparencës
CAPEX	Shpenzime kapitale (kostoja e investimit)
CCU	Kapja dhe përdorimi i karbonit
CH_4	Metani (gaz me efekt serrë)
KTM	*Konferenca e palëve që shërben si takimi i palëve në Marrëveshjen e Parisit* (organ i KKKBNK-së)
CO_2	Dyoksidi i karbonit (gaz me efekt serrë)
KP	*Konferenca e palëve* (në KKKBNK)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PbE	Përshtatja e bazuar në ekosistem
KE	Komisioni Evropian
EE	Eficienca e energjisë
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
EPBD	Direktiva për Performancën e Energjisë së Ndërtesave (Direktiva BE 2010/31/BE)
CPE	Certifikata e performancës së energjisë
ESCO	Shoqëria e Shërbimeve Energjetike
ETS	Sistemi për Tregtimin e Shkarkimeve (ETS i BE-së)
BE	Bashkimi Evropian
BE-27	Bashkimi Evropian (27 shtetet anëtare)
EUR	Euro (monedha evropiane)
Gazet-F	Gazet e fluorinuara (gazet industriale me PNG të lartë, si HFC-të, PFC-të, SF_6, NF_3)
PPTT/FOLU	Pylltaria dhe përdorimet e tjera të tokës (sektor)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
GES	Gaz me efekt serrë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
PPKT	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
GO	Garancia e origjinës (certifikata e energjisë së rinovueshme)
PNG	Potenciali i ngrohjes globale
HFC	Hidrofluorokarbon
PVD	Produktet e vjela të drurit (depozita e karbonit në lëndët drusore)
ICTU	Informacion për të lehtësuar qartësinë, transparencën dhe kuptimin
IGJEO	Instituti i Gjeoshkencave (Shqipëri)
GNPNK	Grupi Ndërministror i Punës për Ndryshimet Klimatike
IPA	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit (program financimi i BE-së)
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
PIPP	Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve
PTNPTP/LULUCF	Përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet
ZMF	Zonë mesdhetare fushore
ZMK	Zonë mesdhetare kodrinore
MMR	Rregullorja për Mekanizmat e Monitorimit
ZMM	Zonë mesdhetare malore
ZMPM	Zonë mesdhetare paramalore
N_2O	Oksidi i azotit (gaz me efekt serrë)
PKP	Plani Kombëtar i Përshtatjes
ND-GAIN	Nisma Globale e Përshtatjes Notre Dame

Akronimi	Emërtimi i plotë
KKP/NDC	Kontributi Kombëtar i Përcaktuar
KKP 3.0	**Kontributi i tretë** Kombëtar i Përcaktuar (KKP-ja e Shqipërisë për periudhën 2025–2035)
PKEK	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës
NF_3	Trifluoridi i azotit (gaz me efekt serrë)
DIK/NID	Dokumenti i Inventarit Kombëtar
RIK/NIR	Raporti i Inventarit Kombëtar
PFC	Perfluorokarbon
FV	Fotovoltaike (teknologji diellore fotovoltaike)
ER	Energjia e rinovueshme
BRE	Burimet e energjisë së rinovueshme
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
SF6	Hekzafluoridi i squfurit (gaz me efekt serrë)
RrND	Rritja e nivelit të detit
TPS	Trajektoret e përbashkëta socio-ekonomike
TPS 1–1.9	Trajektorja e përbashkët socio-ekonomike 1–1.9 (skenari i qëndrueshmërisë/shkarkimeve të ulëta)
TPS 2–4.5	Trajektorja e përbashkët socio-ekonomike 2–4.5 (skenari mesatar)
TPS 5–8.5	Trajektorja e përbashkët socio-ekonomike 5–8.5 (skenari i lëndëve djegëse fosile/shkarkimeve të larta)
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
USD	Dollarë amerikanë (US $)
WAM	Me masa shtesë (skenar)
WEM	Me masa ekzistuese (skenar)

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Përshkrimi i KKP-së 3.0 të Shqipërisë
Tabela 2: Objektivat, lidhur me përqindjes e energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme (BRE) në raport me konsumin final bruto të energjisë
Tabela 3: Objektivat për konsumin final të energjisë
Tabela 4: Përmbledhje e veprimeve kryesore për zbutjen
Tabela 5: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e bujqësisë
Tabela 6: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e turizmit
Tabela 7: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e energjisë
Tabela 8: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e transportit
Tabela 9: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e zhvillimit urban
Tabela 10: Masat e përshtatjes sipas bashkisë
Tabela 11: Buxheti i planifikuar për kostot e masave të përshtatjes
Tabela 12: Informacioni për KKP 3.0 sipas shtojcës I, të vendimit 4/KTM.1 (seanca e parë e Konferencës së palëve që shërben si takimi i palëve në Marrëveshjen e Parisit)

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Krahasim i KKP 3.0 me KKP-në e mëparshme (2021)
Figura 2: Projeksioni i shkarkimeve të GES-ve (burimi: PKEK 2025)
Figura 3: Projeksioni i shkarkimeve të GES-ve sipas skenarit WEM (burimi: PKEK 2025)
Figura 4: Projeksioni i shkarkimeve të GES-ve sipas skenarit WAM (burimi: PKEK 2025)
Figura 5: Alokimi sektorial i reduktimeve të projektuara të shkarkimeve nga politikat dhe masat shtesë të planifikuara
Figura 6: Temperatura mesatare në sipërfaqe (°C), në Shqipëri (1950–2020) Burimi: Grupi i njohurive mbi ndryshimet klimatike, 2021

Figura 7: Reshjet mesatare (mm) në Shqipëri (1950–2020)
Figura 8: Anomalia e nivelit të detit (mm) në Shqipëri (1993–2015)

1. PËRMBLEDHJE

Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (KKP), i rishikuar, i Shqipërisë paraqet një ambicie që kontribuon në arritjen e objektivave të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) dhe të Marrëveshjes së Parisit, si dhe në arritjen e strategjive dhe planeve rajonale dhe kombëtare. Në nivel kombëtar, KKP-ja është në përputhje me strategjitë, planet dhe qëllimet afatgjata kombëtare dhe sektoriale të zhvillimit të Shqipërisë. Në nivel rajonal, meqenëse Shqipëria është në procesin e negociatave për t'u bërë Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian (BE), KKP-ja është, gjithashtu, në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së dhe objektivin për një ekonomi neutrale të BE-së ndaj klimës deri në vitin 2050. Duke përmbushur objektivat e saj të NECP-së dhe NDC-së, Shqipëria kontribuon, gjithashtu, në objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së, Agjendës së Gjelbër të Ballkanit Perëndimor dhe Deklaratës së Sofjes, si dhe në angazhimet e saj në kuadër të Komunitetit të Energjisë.

KKP-ja u përgatit duke marrë në konsideratë kërkesat që vijnë nga KKKBNK-ja, kuadrin ligjor kombëtar dhe përfshirjen aktive të institucioneve qendrore me Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si institucionet kryesore, si dhe konsultime me palë të ndryshme të interesuara nga shoqëria civile dhe akademia.

Dokumenti i ri i KKP-së u përgatit duke marrë parasysh rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE dhe bazohet në dy dokumente të rëndësishme, përkatësisht Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) të rishikuar dhe Strategjinë e re Kombëtare të Përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. KKP-ja përfshin, gjithashtu, tabelën që përmban informacionin për të lehtësuar qartësinë, transparencën dhe kuptimin.

KKP-ja 3.0 e Shqipërisë përcakton objektivin për t'i mbajtur shkarkimet e gazeve me efekt serrë (GES) nën 9,195 kiloton CO_2 ekuivalent ($ktCO_2eq$) brenda vitit 2035. Objektivi përfaqëson një kufizim të rritjes së shkarkimeve deri në 17,4% mbi nivelet e vitit 1990, kur totali i shkarkimeve ishte 7,834.07 $ktCO_2eq$. Në vend që të lejojë rritje të pakontrolluar të shkarkimeve, Shqipëria synon të kufizojë rritjen e shkarkimeve, duke arritur njëkohësisht zhvillim të qëndrueshëm, si dhe merr parasysh shkarkimet e dyoksidit të karbonit (CO_2), metanit (CH_4), oksidit të azotit (N_2O) dhe hidrofluorokarbonëve (HFC).

KKP-ja e Shqipërisë është një objektiv për të gjithë ekonominë, që mbulon të gjithë sektorët vendas që raportohen aktualisht në Raportin e Inventarit Kombëtar (NIR). Ky objektiv përfaqëson një progres të qartë krahasuar me KKP-në e mëparshme, e cila përcaktonte një objektiv të pakushtëzuar për reduktimin e emetimeve me 20.9% krahasuar me skenarin *Business-as-Usual* (BaU) deri në vitin 2030 (ekuivalent me një kufi prej rreth 11,978 $ktCO_2eq$). Në formulimin e ri, i cili bazohet në vitin 1990 si vit reference, KKP 3.0 përcakton një nivel maksimal emetimesh prej 10,210 $ktCO_2eq$ deri në vitin 2030, që korrespondon me 30.3% mbi nivelin e vitit 1990, dhe 9,195 $ktCO_2eq$ deri në vitin 2035, që korrespondon me 17.4% mbi nivelin e vitit 1990.

Dokumenti përfshin, gjithashtu, pjesën e përshtatjes, e cila është plotësisht e harmonizuar me draftin përfundimtar të Planit Kombëtar të Përshtatjes të Shqipërisë dhe fokusohet në sektorët prioritarë si: bujqësia, pyjet dhe kullotat, turizmi, energjia, transporti dhe zhvillimi urban. Këta sektorë janë thelbësorë për ekonominë e Shqipërisë, duke mbështetur jetesën, infrastrukturën dhe burimet natyrore.

2. PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE PROCEDURALE

Procesi i planifikimit për Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (KKP) të Shqipërisë është i integruar ngushtësisht me zhvillimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), duke garantuar kështu koherencën mes angazhimeve klimatike dhe politikave për energjinë. Të dyja

këto procese kanë përfituar nga mbështetja e vazhdueshme teknike e ofruar nga *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* (GIZ), i cili ka luajtur një rol kyç, duke lehtësuar ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin e të dhënave dhe koordinimin mes grupeve të interesit.

Shqipëria është palë në një sërë marrëveshjesh mjedisore shumëpalëshe, duke përfshirë në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) që nga viti 1994, si dhe ka ratifikuar Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshjen e Parisit, përkatësisht në vitet 2005 dhe 2016. Shqipëria ka miratuar në vitin 2020 ligjin "Për ndryshimet klimatike" (ligji nr. 155/2020, datë 17.12.2020)[1]. Ky ligj është përafruar pjesërisht me kërkesat e KKKBNK-së dhe pasqyron, gjithashtu, disa kërkesa që burojnë nga legjislacioni i BE-së për klimën.

Ligji "Për ndryshimet klimatike", neni 7:

1. Dokumenti i NDC-së përcakton kontributin kombëtar për reduktimin e gazeve me efekt serrë përkundrejt arritjes së objektivit global të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, për mbajtjen e temperaturave në 2°C, duke kufizuar rrezikun e ardhshëm dhe kostot e përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës.

2. Kontributi Kombëtar i Përcaktuar rishikohet çdo 4 vjet dhe, nëse është e mundur, përditësohet me synimin për ta rritur objektivin e reduktimit të gazeve me efekt serrë në atë masë që lejojnë kushtet e vendit.

3. Ministria koordinon me grupin ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike dhe, sipas rastit, edhe me aktorë të tjerë, punën për zbatimin dhe rishikimin e dokumentit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Metodologjia për hartimin dhe procesin e përgatitjes së dokumentit të NDC-së miratohet me udhëzim të ministrit, sipas modelit të miratuar ose të rekomanduar nga Konventa, në përputhje me kushtet e vendit.

5. Dokumenti "Përcaktimi i Kontributit Kombëtar" miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit dhe dorëzohet në sekretariatin e Konventës.

Shqipëria e ka përgatitur dokumentin e parë të **KKP-së** në vitin 2015 dhe e ka miratuar atë me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 762, datë 9.9.2015[2]. Bazuar, gjithashtu, në zhvillimet dhe kërkesat më të fundit në kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar, u rishikua KKP-ja dhe në vitin 2021 u përgatit versioni i përditësuar, i cili u miratua përmes VKM-së nr. 581, datë 6.10.2021[3] dhe u dorëzua më 12.10.2021. Meqenëse ligji shqiptar për ndryshimet klimatike kërkon që KKP-ja të rishikohet brenda një periudhe katërvjeçare, Shqipëria duhet ta miratojë KKP-në e re brenda vitit 2025. Megjithatë, për shkak të kohëzgjatjes së procesit të miratimit, pritet që vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) për miratimin e KKP 3.0 të miratohet brenda vitit 2026.

Shqipëria përgatiti **PKEK-në** e parë gjatë periudhës 2020–2021, e cila u miratua përmes VKM-së nr. 872, datë 29.12.2021[4]. Shqipëria nisi një rishikim të PKEK-së në vitin 2022 për të përfshirë objektivat e përditësuar mbi energjinë dhe klimën për vitin 2030 dhe për t'iu përgjigjur rekomandimeve të bëra nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (EnCS) për sa i përket cilësisë dhe plotësisë së dokumenteve të dërguara të PKEK-së. Ky proces rishikimi u realizua gjatë viteve 2024 dhe 2025, dhe u mbështet nga asistenca teknike e GIZ-it. Plani Kombëtar për

---

[1] Aktet e Ministrisë së Mjedisit.

[2] Vendime të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave VKM-ja nr. 762, datë 16.9.2015, "Për miratimin e dokumentit për përcaktimin e Kontributit Kombëtar të Pikësynuar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike".

[3] Vendime të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, VKM-ja nr. 581, datë 6.10.2021, "Për miratimin e dokumentit të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar".

[4] VKM-ja nr. 872, datë 29.12.2021, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020–2030".

Energjinë dhe Klimën ndodhet në fazën përfundimtare të miratimit. Gjithashtu, është përfunduar procesi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), ndërsa miratimi përfundimtar i planit pritet të realizohet brenda muajit shtator 2026.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian **(SKZHIE III)** e Shqipërisë mbulon periudhën 2022–2030 dhe u miratua zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave përmes vendimit nr. 88, datë 22.2.2023, duke përcaktuar kuadrin gjithëpërfshirës për reforma në përputhje me anëtarësimin në BE dhe me zhvillimin e qëndrueshëm. Më pas, nisi zbatimi në praktikë përmes instrumenteve periodike, si Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 dhe strategjitë e tjera ndërsektoriale, të cilat burojnë dhe koordinohen nga SKZHIE III[5].

Prioritetet dhe masat e përshtatjes të paraqitura në këtë NDC janë nxjerrë nga Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) i Shqipërisë 2026–2036, i miratuar në qershor 2026 dhe janë në përputhje me të. Ky plan ofron kornizën strategjike për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe formon bazën për komponentin e përshtatjes së këtij NDC.

Ndonëse dokumenti i parë i PKEK-së dhe versioni i dytë (i përditësuar) i KKP-së u miratuan të dy në vitin 2021, këto dokumente nuk ishin plotësisht të pajtueshme. PKEK-ja ndoqi qasjen e kërkuar nga Rregullorja për Qeverisjen e Energjisë, duke përfshirë zhvillimin e politikave dhe masave, si dhe skenarët WEM (me masa ekzistuese) dhe WAM (me masa shtesë). Nga ana tjetër, KKP-ja miratoi një kuadër tjetër të bazuar në skenarin BaU (punë si zakonisht) dhe në skenarët sipas objektivave të KKP-së (Kontributi Kombëtar i Përcaktuar). Për më tepër, modelimi i shkarkimeve totale nuk ishte konsistent mes dy dokumenteve.

U arrit në konkluzionin se, në rishikimin e kësaj NDC-je, duhen ndjekur rezultatet dhe modelimi i PKEK-së së rishikuar për arsyet e mëposhtme:

- Skenarët dhe rruga drejt neutralitetit të karbonit duhet të jenë të qarta dhe të ndjekin një linjë të vetme të dakordësuar (meqenëse si PKEK-ja, po ashtu edhe PKK-ja miratohen nga Këshilli i Ministrave);

Nga ana tjetër, KKP-ja do të marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në raportimin ndaj UNFCCC-së, veçanërisht përmes Raportit Dyvjeçar të Transparencës (Biennial Transparency Report – BTR), ndërsa PKEK-ja do të mbetet instrumenti kryesor për raportimin, në kuadër të Komunitetit të Energjisë;

- Shqipëria është në procesin për t'u bërë një shtet anëtar dhe për këtë arsye PKEK-ja do të ketë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, qoftë si dokument reference, po ashtu edhe për raportimin e problemeve;
- PKEK-ja është rishikuar duke marrë parasysh të dhënat më të fundit në dispozicion dhe dokumentet kryesore të planifikimit (strategjitë dhe planet e veprimit) në fuqi;
- Gjithashtu, PKEK-ja merr parasysh kërkesat dhe rezultatet e pritura nga KKP-ja;
- Ka disa dokumente strategjike, si ato në vijim, që përbëjnë bazën e PKEK-së dhe KKP-së:
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (2022–2030);
- Strategjia Kombëtare e Energjisë (2018–2030);
- Plani Kombëtar i Përshtatjes[6] (2026–2036);
- Për miratimin e Dokumentit Strategjik dhe Planeve Kombëtare për Zbutjen e Gazrave Serrë dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (2019) – Dokumenti i Politikave për Pyjet (2019–2030);
- Strategjia Kombëtare për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin (2021-2027);
- Strategji të tjera sektoriale.

---

[5] Qeveria Shqiptare Këshilli i Ministrave, VKM nr. 88, datë 22.2.2023, Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030.

[6] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 10.6.2026 "Për miratimin e planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036"

Për sa i përket vlerësimit të kostove, nuk ka një llogaritje specifike të kostove të përgatitur vetëm për KKP-në. Duke qenë se pjesët e KKP-së për zbutjen dhe përshtatjen kanë qenë të harmonizuara me dokumentet ekzistuese, të cilat kanë kryer kostimin e tyre, në këtë dokument përmendet vetëm një referencë ndaj kostove të masave dhe jo një kosto që lidhen në veçanti me KKP-në.

3. RRETHANAT KOMBËTARE

Shqipëria ndodhet në cepin jugperëndimor të Gadishullit të Ballkanit dhe zë një sipërfaqe prej 28 748 kilometra katrorë, me një gjatësi maksimale prej rreth 340 km dhe gjerësi maksimale prej rreth 150 km. Pjesa më e madhe e vendit ka terren të thyer dhe malor. Maja më e lartë është Korabi, në zonën verilindore, me lartësi 2752 m. Shqipëria ka një vijë kufitare me gjatësi 1094 km, 30% e së cilës përbëhet nga bregdeti i detit Adriatik dhe detit Jon, si dhe nga disa liqene ndërkufitare, ndër të cilët vlen të përmendet liqeni i Shkodrës (më i madhi në Ballkan) dhe liqeni i Ohrit (më i thelli). Popullsia në Republikën e Shqipërisë, sipas censit të vitit 2023, ishte 2 402 113 banorë, një rënie me 420 000 banorë krahasuar me censin e vitit 2011. Dendësia e popullsisë së Shqipërisë është 83,6 banorë për kilometër katror dhe rënia e popullsisë ndjek tendencën e vëzhguar që nga viti 1990, që vjen si pasojë e fenomenit të emigracionit.

Konteksti politik

Shqipëria aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), në prill të vitit 2009 dhe që nga qershori i vitit 2014 është vend zyrtar kandidat për anëtarësim. Anëtarësimi në BE është një objektiv kryesor politik dhe strategjik, i cili formëson zhvillimin ligjor, ekonomik dhe institucional të Shqipërisë. Më 25 mars 2022, Këshilli i BE-së vendosi të hapë negociatat për anëtarësim, vendim ky i cili u miratua nga Këshilli Evropian ditën pasuese (26 mars 2022). Shqipëria ka bërë progres të qëndrueshëm në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE. Integrimi në BE mbetet një prioritet kryesor i qeverisë shqiptare dhe procesi i negociatave shihet si një faktor nxitës thelbësor për avancimin e reformave që lidhen me BE-në sipas metodologjisë së rishikuar. Shqipëria miratoi pozicionin negociues për *grupkapitullin 4 të legjislacionit të BE-së: "Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm"* dhe e dorëzoi atë zyrtarisht në KE, në qershor të vitit 2025. Negociatat për grupkapitullin 4, i cili kombinon katër kapituj që lidhen me transportin (kapitulli 14), energjinë (kapitulli 15), rrjetet transevropiane (kapitulli 21), ndryshimet mjedisore dhe klimatike (kapitulli 27), u hapën zyrtarisht më 16 shtator 2025, pas Konferencës së 6-të Ndërqeveritare me Shqipërinë.

Ndryshimet mjedisore dhe klimatike janë, gjithashtu, në fokus të qeverisë së re së formuar nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025. Në programin e qeverisë, një nga angazhimet për sektorin është: "*të harmonizohen politikat klimatike në të gjithë sektorët për të reduktuar shkarkimet dhe për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike.*". Ky harmonizim është mbuluar pjesërisht përmes SKZHIE III, vizioni i së cilës përshkruan "një ekonomi të fortë dhe të qëndrueshme për Shqipërinë përmes një rruge me zero shkarkime dhe rritje ekonomike të gjelbër".

Bashkëpunimi rajonal sipas Procesit të Berlinit dhe miratimi nga ana e Shqipërisë i Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor kanë forcuar më tej angazhimin e saj për një të ardhme neutrale ndaj karbonit, brenda vitit 2050. Shqipëria është e angazhuar në zbatimin e Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër dhe është përfshirë në mënyrë aktive në përditësimin më të fundit të këtij plani. Gjithashtu, Shqipëria është anëtare në shumë marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe dhe anëtare aktive në Konferencën e Palëve, si dhe po punon drejt përmbushjes së këtyre angazhimeve.

Konteksti ekonomik

Ekonomia e Shqipërisë ka regjistruar rritje të qëndrueshme. Në vitin 2024, rritja ishte rreth 4% ndërsa projeksionet për vitet e ardhshme janë disi më të ulëta, por megjithatë pozitive (rreth

3–3,5%). Ekonomia dominohet nga sektori i shërbimeve, ndërsa sektorët kyç janë turizmi, tregtia, transporti dhe pasuritë e paluajtshme. Vlen të theksohet se bujqësia mbetet e rëndësishme, sidomos për punësimin, por kontributi i saj relativ është në rënie. Deficiti ka njohur luhatje; borxhi publik është në nivele mesatare, rreth 55–60% e PBB-së në vitet e fundit (INSTAT, 2025).

Zbatimi i politikave për zbutjen të Shqipërisë, në kuadër të PKEK-së dhe KKP-së 3.0, pritet të gjenerojë përfitime të konsiderueshme makroekonomike dhe sociale. Investimet në eficiencën e energjisë (EE) dhe energjinë e rinovueshme (ER) jo vetëm që kontribuojnë në reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, por prodhojnë, gjithashtu, efekte pozitive në të ardhurat familjare, në punësim dhe në financat publike. Masat për eficiencën e energjisë në ndërtesa dhe pajisje mund të reduktojnë kostot energjetike, duke rritur kështu të ardhurat familjare të disponueshme dhe duke ulur varfërinë energjetike, sidomos për grupet me të ardhura të ulëta. Këto përmirësime rrisin standardet e jetesës dhe stimulojnë veprimtarinë ekonomike në nivel vendor përmes shpenzimeve më të larta të konsumatorëve.

Për sa i përket buxhetit të shtetit, masat për EE-në dhe ER-në mund të kërkojnë fillimisht subvencione ose stimuj fiskalë, por me kalimin e kohës ato përmirësojnë ekuilibrat fiskalë përmes rritjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat, nga vendet e punës së krijuara rishtazi dhe nga reduktimi i shpenzimeve publike për energjinë. Efektet e punësimit janë veçanërisht pozitive: programet për rinovimin e ndërtesave dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme janë projektuar që të gjenerojnë mijëra vende pune "të gjelbra" në ndërtim, prodhim dhe mirëmbajtje, duke kompensuar nivelin e ulët të humbjes së vendeve të punës në sektorët që lidhen me energjinë nga lëndët fosile. Për shembull, sipas skenarëve të PKEK-së, investimet në ER dhe EE mund të krijojnë deri në 12 000 vende pune me kohë të plotë brenda vitit 2030. Për më tepër, zgjerimi i kapaciteteve të energjisë diellore fotovoltaike (FV) dhe eolike pritet të shtojë mbi 3000 vende të reja pune gjatë fazave të instalimit dhe përdorimit. Këto masa mbështesin bashkërisht rritjen e PBB-së, stimulojnë novacionin dhe forcojnë tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie me shkarkime të ulëta, të qëndrueshme dhe përfshirëse, dhe njëkohësisht janë në përputhje me objektivat e BE-së për klimën dhe energjinë.

Konteksti mjedisor

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat parësorë të vendit. Mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e natyrës njihen si vlera themelore kushtetuese, të cilat çdo individ ka përgjegjësinë t'i mbrojë dhe përmirësojë.

Që nga viti 2002, vendi ka filluar procesin e harmonizimit të legjislacionit mjedisor me legjislacionin e BE-së dhe janë miratuar ligje të reja për mjedisin, mbrojtjen e natyrës, burimet ujore, cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve. Ka ligje specifike që rregullojnë procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe vlerësimit strategjik mjedisor (VSM), si dhe për kontrollin e integruar të ndotjes (KIN), menaxhimin e rrezikut dhe kimikatet.

Ndonëse Shqipëria mund të konsiderohet si një vend që ka hedhur themelet për progres mjedisor dhe mbrojtje të mjedisit, sfida më e madhe është zbatimi i legjislacionit, në veçanti lidhur me menaxhimin e ujërave dhe të mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, energjinë, ndotjen industriale, menaxhimin e rrezikut, si dhe me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Për më tepër, kapacitetet administrative janë të pamjaftueshme në nivel qendror dhe vendor, sidomos për sa i përket kualifikimeve dhe burimeve njerëzore në dispozicion për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin, energjinë dhe ndryshimet klimatike.

Konteksti i politikave për klimën dhe energjinë

Politikat kombëtare për klimën dhe energjinë luajnë një rol qendror në adresimin e sfidave mjedisore, duke u fokusuar në reduktimin e GES-ve, në zgjerimin e energjisë së rinovueshme dhe në eficiencën e energjisë. Këto masa shoqërohen me përpjekjet në bujqësi, transport dhe

ruajtjen e biodiversitetit. Shqipëria synon të ekuilibrojë zhvillimin e energjisë me mbrojtjen e ekosistemit përmes integrimit të aspekteve të ndikimit në mjedis në planifikimin e infrastrukturës. Veprimet për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike mbështesin shëndetin e tokës, bujqësinë, biodiversitetin dhe restaurimin e habitateve natyrore.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Parisit nga qeveria (Nju Jork, 22 prill 2016), Shqipëria hyri në një epokë të re në procesin e politikave ndërkombëtare për klimën, në të cilën të gjitha palët synojnë bashkërisht ta kufizojnë rritjen globale të temperaturës deri në 2°C mbi nivelet paraindustriale.

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030, Planet Kombëtare për Energjinë dhe Klimën (PKEK) 2020–2030 dhe Strategjia Kombëtar për Ndryshimet Klimatike që përfshin Planin e Veprimit të Zbutjes, si dhe Strategjia Kombëtare e Transportit, kanë përcaktuar objektiva dhe synime për rritjen e sigurisë së furnizimit përmes investimeve në sektorin e energjisë elektrike, penetrimit të gazit në tregun shqiptar dhe rritjes së përqindjes së BRE-ve dhe eficiencës së energjisë, pasuar nga reduktimi i shkarkimeve të GES-ve.

Në fushën e përshtatjes, PKP 2026–2036 (qershor 2026) përcakton kuadrin strategjik për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në të gjithë sektorët prioritarë, duke plotësuar këto strategji të energjisë dhe zbutjes, dhe mbështetet më tej nga planifikimi i biodiversitetit dhe mbrojtjes së ekosistemit, siç është Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin.

Konteksti social

Politikat për klimën dhe energjinë janë projektuar për të qenë gjithëpërfshirëse nga ana sociale, duke synuar përmirësimin e mirëqenies, kapitalit dhe aksesit në burimet e energjisë, veçanërisht për popullatat e cenueshme dhe të margjinalizuara, duke përfshirë gratë, të rinjtë dhe komunitetet rurale. Investimet e gjelbra në ndërtim, energji të rinovueshme dhe në eficiencën e energjisë jo vetëm që po reduktojnë shkarkimet, por, gjithashtu, po krijojnë vende pune të denja dhe mundësi për jetesë të denjë, si dhe rritje të pjesëmarrjes së grave dhe profesionistëve të rinj në sektorët e gjelbër në zhvillim. Këto investime kontribuojnë në uljen e varfërisë, lëvizshmërinë sociale dhe në zhvillimin me përgjegjshmëri gjinore.

Është vënë theksi tek aspekte si pjesëmarrja e publikut dhe angazhimi i grupeve të interesit për të garantuar që tranzicionet të jenë transparente, të barabarta dhe të pranueshme nga ana sociale, duke u dhënë zë shoqërisë civile, komuniteteve vendore dhe grupeve të nënpërfaqësuara. Programet e edukimit, trajnimit dhe ndërgjegjësimit promovojnë më tej menaxhimin e kujdesshëm mjedisor, përfshirjen e të rinjve dhe ngritjen e kapaciteteve për veprimet përfshirëse për klimën.

Në mënyrë të veçantë, politikat kombëtare për eficiencën e energjisë synojnë të përmirësojnë përdorimin efikas të energjisë dhe të ulin konsumin final të saj, në përputhje me objektivat e përcaktuar në PKEK. Zbatimi i këtyre masave pritet të kontribuojë në ofrimin e shërbimeve energjetike më të përballueshme dhe në rritjen e qëndrueshmërisë së familjeve, veçanërisht të grupeve vulnerabël dhe atyre me të ardhura të ulëta.

Megjithëse objektivat për eficiencën e energjisë udhëhiqen nga synimet e përcaktuara në PKEK, Shqipëria nuk ka përcaktuar një objektiv sasior të veçantë për uljen e varfërisë energjetike deri në vitin 2035. Në vend të kësaj, adresimi i varfërisë energjetike për familjet me të ardhura të ulëta synohet përmes zbatimit të masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë. Nëpërmjet këtyre masave, tranzicioni i Shqipërisë drejt një ekonomie me emetime të ulëta dhe një sistemi energjetik të qëndrueshëm synon të harmonizojë objektivat mjedisorë me mirëqenien sociale, duke përmirësuar cilësinë e jetës dhe qëndrueshmërinë e të gjithë qytetarëve, në përputhje me parimin që askush të mos mbetet pas.

Evolucioni i shkarkimeve të CO_2, CH_4, N_2O dhe HFC-ve me kalimin e kohës

Baza e të dhënave përmbledh shkarkimet e gazeve me efekt serrë (GES) të Shqipërisë të shprehura në kilotonë ekuivalent CO_2 (kt CO_2-eq) për periudhën nga viti 1990 deri në vitin 2022. Gazrat e mbuluar janë dyoksidi i karbonit (CO_2), metani (CH_4), oksidi i azotit (N_2O) dhe hidrofluorokarbonet (HFC), të paraqitura si me edhe pa sektorin e PTNPTP/LULUCF (përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet). Çdo gaz shfaq sjellje të dallueshme që pasqyron strukturën e ekonomisë së Shqipërisë, tranzicionin e saj energjetik, intensitetin bujqësor dhe sistemet e menaxhimit të mbetjeve. Këto të dhëna bazohen në Raportin më të fundit Kombëtar të Inventarit (NIR) të Shqipërisë, i cili mbulon periudhën 1990–2022. Për të dhënat e plota, ndarjen sipas sektorëve dhe tabelat përkatëse, lexuesi i referohet këtij raporti.

Në vitin 1990, shkarkimet e CO_2 të Shqipërisë (duke përjashtuar LULUCF-në) ishin rreth 9,622 kt, ndërsa duke përfshirë LULUCF-në ato ishin pak më të ulëta në 8,990 kt, duke treguar se sektori i përdorimit të tokës vepronte si një thithës modest i karbonit. Gjatë dekadave në vijim, shkarkimet shfaqën një trend të luhatshëm në rënie, kryesisht për shkak të ndryshimeve strukturore në sistemin energjetik, rënies së industrisë së rëndë dhe ndryshimeve në menaxhimin e tokës. Deri në vitin 2022, shkarkimet totale të CO_2 duke përjashtuar LULUCF-në kishin rënë në 7,006 kt, ndërsa duke përfshirë LULUCF-në ato qëndruan në 7,200 kt. Kjo përfaqëson një rënie të përgjithshme prej afërsisht 27% nga nivelet e vitit 1990, pavarësisht ndryshimeve të moderuara nga viti në vit.

Gjatë fillimit të viteve 1990, shkarkimet e CO_2 ishin relativisht të larta, kryesisht për shkak të djegies së lëndëve djegëse fosile në sektorët industrialë dhe të energjisë gjatë periudhës së tranzicionit pas rënies së industrive shtetërore. Periudha 1990–1995 shënon një rënie të ndjeshme të niveleve të CO_2, që përkon me ristrukturimin ekonomik, mbylljen e industrisë së rëndë dhe uljen e kërkesës për energji. Në vitet në vijim, ndodh një rimëkëmbje graduale ndërsa ekonomia stabilizohet dhe konsumi i energjisë rritet, megjithëse intensiteti i karbonit mbetet më i ulët se nivelet para vitit 1990. CO_2 mbetet kontribuesi kryesor në të gjithë serinë e GES-ve, duke përbërë afërsisht 65–75% të shkarkimeve totale të GES-ve.

Shkarkimet e metanit ndoqën një trajektore të ndryshme. Duke përjashtuar LULUCF-në, emetimet e CH_4 në vitin 1990 ishin në 1,856 kt CO_2-eq dhe ranë deri në vitin 2022 në 1,198 kt, një ulje prej rreth 35%. Përfshirja e efekteve të LULUCF-së i ndryshoi lehtësisht këto totale, duke paraqitur ndërveprimin e kufizuar midis metanit dhe dinamikës së përdorimit të tokës. Burimet kryesore të shkarkimit të CH_4 mbeten sektorët e bujqësisë dhe të mbetjeve – veçanërisht fermentimi enterik i bagëtive dhe gazi i landfilleve, dhe që të dy kanë paraqitur zbutje graduale që nga fillimi i viteve 2000. Shkarkimet e metanit (CH_4) shfaqin një trend më të sheshtë, por të luhatshëm, kryesisht të lidhur me bujqësinë (veçanërisht menaxhimin e bagëtive dhe plehut organik) dhe asgjësimin e mbetjeve të ngurta. Nivelet e CH_4 mbeten mjaft të qëndrueshme gjatë viteve 1990, me ulje të vogla pas përmirësimeve në praktikat e trajtimit të mbetjeve. Megjithatë, nga mesi i viteve 2000 e tutje, ka rritje të lehta që lidhen me rritjen e popullatave të bagëtive dhe zgjerimit urban, të cilat rrisin vëllimin e mbetjeve organike. Kontributi i metanit në shkarkimet totale të GES-ve mesatarisht varion nga 20–25%, duke theksuar rëndësinë e tij të vazhdueshme në inventarin kombëtar.

Shkarkimet e oksidit të azotit (N_2O) kanë luhatur në mënyrë më të parregullt. Në vitin 1990, shkarkimet duke përjashtuar LULUCF-në ishin 685 kt, duke rënë në 283 kt deri në vitin 2022, duke shënuar një ulje prej 59%. Kur përfshihet LULUCF-ja, shkarkimet e N_2O ishin 640 kt në vitin 1990 dhe 364 kt në vitin 2022. Këto vlera paraqesin që ka pasur përmirësime në menaxhimin e fertilizuesve dhe rënie të intensitetit bujqësor, por edhe një kompensim të mundshëm nga shkarkimet që lidhen me tokën dhe pyjet. Shkarkimet e oksidit të azotit (N_2O) zënë % më të vogël në totalin e GES-ve, zakonisht rreth 5–10% e totalit të GES-ve. Trajektorja e shkarkimeve të N_2O është relativisht e qëndrueshme, me ndryshime të vogla që pasqyrojnë

përdorimin e plehrave bujqësore dhe ndryshimet në intensitetin e përdorimit të tokës. Rritjet e lehta të N_2O në fund të viteve 2000 dhe fillim të viteve 2010 përkojnë me rimëkëmbjen bujqësore dhe kultivimin e intensifikuar të të korrave, ndërsa vitet më të fundit sugjerojnë stabilizim për shkak të menaxhimit më të mirë të plehërimit dhe zhvendosjeve drejt praktikave me më pak shkarkime.

4. ZBUTJA

4.1 Objektivi për zbutjen në KKP 3.0

Kontributi Kombëtar i Përcaktuar i Shqipërisë (KKP) përcakton objektivin për t'i mbajtur shkarkimet e gazeve me efekt serrë (GES) nën 9195 kiloton CO_2 ekuivalent ($ktCO_2eq$) brenda vitit 2035 (tabela 1). Ky objektiv bazohet në skenarin "me masa shtesë" (WAM), të parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) 2025 të Shqipërisë, çka pasqyron rritjen e masave të lidhura me politikat për të reduktuar shkarkimet në disa sektorë. Objektivi përfaqëson një kufizim të rritjes së shkarkimeve deri në 17,4% mbi nivelet e vitit 1990, kur totali i shkarkimeve ishte 7834,07 $ktCO_2eq$. Në vend që të lejojë rritje të pakontrolluar të shkarkimeve, Shqipëria synon të kufizojë rritjen e shkarkimeve, duke arritur njëkohësisht zhvillim të qëndrueshëm.

Ky formulim i vitit bazë shënon një përmirësim metodologjik krahasuar me KKP-në e mëparshme, e cila shprehte objektivin e saj si një ulje përqindjeje kundrejt një skenarit BaU; seksioni 4.2 përcakton krahasimin midis dy objektivave.

Objektivi shtrihet në mbarë ekonominë dhe mbulon të gjitha shkarkimet e GES-ve në nivel kombëtar nga sektorët kyçë, ku përfshihen energjia (me përjashtim të transportit ndërkombëtar), proceset industriale dhe përdorimi i produkteve (PIPP), bujqësia, mbetjet, përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (PTNPTP). Ky është një objektiv njëvjeçar për t'u arritur në vitin 2035, i cili mbulon periudhën nga 1 janari 2025 deri më 31 dhjetor 2035. Çka është më e rëndësishmja, angazhimi duhet të realizohet pa u mbështetur në kreditet ndërkombëtare të karbonit për të theksuar përkushtimin e Shqipërisë ndaj veprimeve të brendshme për klimën.

KKP-ja merr në konsideratë shkarkimet e dyoksidit të karbonit (CO_2), metanit (CH_4), oksidit të azotit (N_2O) dhe hidrofluorokarbonëve (HFC). Gazet e tjera, si perfluorokarbonët (PFC), hekzafluoridi i squfurit (SF_6) dhe trifluoridi i azotit (NF_3) nuk përfshihen për shkak të pranisë së tyre të papërfillshme në inventarin kombëtar. Nga ana metodologjike, Shqipëria ndjek Udhëzimet e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK) të vitit 2006 dhe përdor vlerat e Potencialit të Ngrohjes Globale (PNG) për një periudhë kohore 100-vjeçare nga Raporti i Pestë i Vlerësimit i PNNK-së. Përveç objektivit për vitin 2035, Shqipëria po punon, gjithashtu, drejt arritjes së neutralitetit klimatik brenda vitit 2050, i cili është një objektiv afatgjatë i artikuluar edhe në PKEK.

Arritja e objektivit për zbutjen brenda vitit 2035, si dhe e objektivit të ndërmjetëm të përditësuar për vitin 2030, të parashikuar në PKEK 2025 (shihni seksionin 4.2), do të kërkojë zbatim të plotë dhe financim të përshtatshëm të të gjitha masave për zbutjen, të përfshira në PKEK 2025. Kjo do të sigurojë që angazhimet e lidhura me politikat të përkthehen në veprime konkrete, duke i mundësuar Shqipërisë të mbetet në rrugën e duhur drejt objektivave të saj afatgjatë të dekarbonizimit.

Tabela 1: Përshkrimi i KKP-së 3.0 të Shqipërisë.

Informacioni	Përshkrimi
Objektivi dhe përshkrimi	Mbajtja e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES) nën 9195 kiloton CO_2 ekuivalent ($ktCO_2eq$) brenda vitit 2035 për të kufizuar rritjen e shkarkimeve me 17,4% krahasuar me vitin bazë (1990)
Lloji i objektivit	Objektiv njëvjeçar për t'u arritur në një vit specifik krahasuar me vitin fillestar
Viti i synuar	2035 (objektiv njëvjeçar)

Informacioni	Përshkrimi
Viti bazë	1990
Shkarkimet e GES-ve në vitin bazë	7834,07 $ktCO_2eq$
Periudha e zbatimit	2025–2035
Sektorët	KKP-ja e Shqipërisë mbulon të gjithë sektorët kombëtarë që janë raportuar aktualisht në RIK (Raporti i Inventarit Kombëtar)
Gazet	Dyoksidi i karbonit (CO_2), metani (CH_4), oksidi i azotit (N_2O) dhe HFC-të PFC-të, SF6 dhe NF3 nuk mbulohen pasi konsiderohen të papërfillshme.
Kategoritë dhe rezervat e PTNPTP-së	Kategoritë dhe rezervat e përfshira të PTNPTP-së siç raportohen në RIK.
Qëllimi për përdorimin e qasjeve të bashkëpunimit	Objektivi i KKP-së së Shqipërisë do të plotësohet vetëm përmes masave kombëtare, pa përdorimin e krediteve ndërkombëtare. Megjithatë, Shqipëria planifikon të angazhohet në bashkëpunim vullnetar sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Parisit, duke shitur kreditet e karbonit deri në vitin 2035 për të mbështetur zhvillimin me kosto efektive dhe me shkarkime të ulëta. Gjithashtu, po planifikohet një Sistem i ri për Tregtimin e Shkarkimeve (ETS), i harmonizuar me standardet e BE-së dhe që mund të lidhet me ETS-në e BE-së.
Çdo përditësim apo sqarim rreth informacionit të raportuar më parë, sipas rastit	Treguesi i referencës për gjurmimin e progresit të zbatimit të KKP-së do të matet duke përdorur nivelet totale kombëtare të raportuara në Raportin e Inventarit Kombëtar të Shqipërisë. Këto vlera mund të përditësohen për të pasqyruar përmirësimet metodologjike në inventarin e gazeve me efekt serrë (GES). Arritja e objektivit për zbutjen brenda vitit 2035, si dhe e objektivit të ndërmjetëm të përditësuar për vitin 2030, të parashikuar në PKEK 2025, do të kërkojë zbatim të plotë dhe financim të përshtatshëm të të gjitha masave për zbutjen të përfshira në PKEK 2025.

4.2 Krahasimi me objektivin e mëparshëm të KKP-së

Shqipëria ka rishikuar strukturën dhe metodologjinë e objektivit të Kontributit të saj Kombëtar të Përcaktuar (KKP) për të përmirësuar qartësinë dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare. Qasja e përditësuar kalon nga objektivi njëvjeçar i bazuar në skenarin e punës si zakonisht (BaU) në një objektiv të mbështetur në vitin historik bazë, i cili është viti bazë i Konventës, përkatësisht 1990. Ky kalim pasqyron një përmirësim të konsiderueshëm metodologjik. Në vend që t'i referohet një trajektoreje hipotetike të shkarkimeve në të ardhmen, objektivi tanimë bazohet në një vlerë referencë historike të verifikuar. Kjo përmirëson transparencën dhe krahasueshmërinë e angazhimeve të Shqipërisë, si dhe përshtatshmërinë metodologjike të tyre, duke lejuar matje më të qarta të progresit kundrejt një vlere të njohur.

KKP-ja e përditësuar përfaqëson, gjithashtu, një angazhim më ambicioz (figura 1) se ai i paraqitur në KKP-në e mëparshme të dorëzuar nga Shqipëria (tetor 2021). Më parë, vendi ishte zotuar të reduktonte shkarkimet e GES-ve me 20,9% nën nivelin e skenarit BaU, brenda vitit 2030, çka do t'i kufizonte shkarkimet në rreth 11 978 $ktCO_2eq$. Nga ana tjetër, objektivi i ri cakton një kufi të ndërmjetëm më të ulët për shkarkimet e vitit 2030 në bazë të PKEK 2025, përkatësisht nën 10 210 $ktCO_2eq$. Ky objektiv përkon me kufizimin e rritjes së shkarkimeve me jo më shumë se 30,3% mbi nivelet e vitit 1990, dhe nuk mbështetet më në projeksionet mbi nivelin e mundshëm të shkarkimeve në mungesë të veprimeve për klimën. Kjo qasje e re jo vetëm që është më në përputhje me praktikat më të mira sipas Marrëveshjes së Parisit, por pasqyron, gjithashtu, angazhimin e rritur të Shqipërisë ndaj zbutjes së ndryshimeve klimatike.

Për të garantuar gjurmim dhe raportim të saktë, treguesi referencë për KKP-në, pra shkarkimet neto të GES-ve, do të matet duke përdorur të dhënat e dorëzuara përmes Raportit të Inventarit Kombëtar (RIK) të Shqipërisë, i cili shoqëron Raportin Dyvjeçar të Transparencës (BTR). Kjo garanton përputhshmërinë me kërkesat ndërkombëtare të raportimit dhe përmirëson llogaridhënien. Ndryshimet që janë bërë në KKP-në e Shqipërisë sinjalizojnë një angazhim

ndaj një qeverisjeje më rigoroze kundrejt klimës dhe një gatishmëri për të qenë në përputhje me pritshmëritë e ndryshueshme ndërkombëtare për transparencë dhe ambicie.



Figura 1: Krahasim i KKP 3.0 me KKP-në e mëparshme (2021).

4.3 Projeksioni i shkarkimeve dhe përthithjeve të GES-ve

Për zhvillimin e KKP 3.0, Shqipëria ka marrë parasysh dy skenarët e projeksioneve (figura 2) të parashikuar në Planin e saj Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) 2025:

- Skenari WEM (me masa ekzistuese), i cili përfshin të gjitha politikat dhe masat që janë miratuar dhe zbatuar zyrtarisht me vendim qeverie;
- Skenari WAM (me masa shtesë), i cili bazohet në WEM përmes përfshirjes së politikave dhe masave të planifikuara që janë aktualisht duke u diskutuar dhe që kanë gjasa reale të miratohen.

Objektivat e përcaktuar në PKEK dhe KKP 3.0 bazohen në skenarin WAM, i cili është zgjedhur si skenari referencë për KKP-në, për shkak të potencialit të tij më ambicioz për zbutjen.

Shqipëria ka ndërmarrë angazhim të arrijë neutralitetin klimatik brenda vitit 2050, siç parashikohet në PKEK. Rrjedhimisht, përditësimet e ardhshme për perspektivën e vitit 2050 do të pasqyrojnë këtë objektiv afatgjatë.

Figura 2: Projeksioni i shkarkimeve të GES-ve (burimi: PKEK 2025).

Në **skenarin WEM** (figura 3), shkarkimet e përgjithshme të GES-ve tregojnë një tendencë në rritje, me kontribute të kufizuara nga sektori i transformimit të energjisë. Shkarkimet rriten ndjeshëm gjatë viteve me klimë të thatë (çdo pesë vjet pas vitit 2022).

Sektori i transportit mbetet burimi më i madh i shkarkimeve, nivelet e të cilit projektohen të rriten deri në 36% brenda vitit 2035 krahasuar me vitin 2020, pasi kërkesa në rritje për lëvizshmëri vijon të tejkalojë përpjekjet për elektrifikim. Më pas, vjen sektori industrial, me shkarkime që projektohen të rriten deri në 73%, të nxitura kryesisht nga aktivitetet e lidhura me energjinë dhe rritjen e PBB-së. Sektori minerar, veçanërisht prodhimi i çimentos, mbetet burimi më i madh dhe më i vështirë për t'u dekarbonizuar, pasi ka nivel elektrifikimi minimal krahasuar me prodhimin e aliazheve të hekurit, i cili mbështetet tashmë në furrnaltat me hark elektrik.

Nga ana tjetër, sektori i banesave arrin reduktime modeste, rreth 16% brenda vitit 2035, kryesisht për shkak të përmirësimit të strukturave të ndërtesave dhe kalimit drejt teknologjive ekologjike për ngrohjen dhe ujin e ngrohtë. Ndërkohë, shkarkimet nga sektori i shërbimeve pritet të rriten ndjeshëm, përkatësisht me 68% në të njëjtën periudhë, kryesisht për shkak të zhvillimit të vazhdueshëm ekonomik.

Shkarkimet nga prodhimi i energjisë elektrike mbeten të ulëta për shkak të përdorimit të kufizuar të termocentralit të Vlorës, i cili është përshtatur për të punuar me gaz natyror. Ky central funksionon kryesisht gjatë viteve të thata dhe duke filluar nga viti 2032 e në vijim, kërkesa do të justifikojë kostot vjetore operacionale.

Shkarkimet në sektorin e bujqësisë mbeten kryesisht të qëndrueshme, me një ulje prej vetëm 4% brenda vitit 2035 krahasuar me vitin 2020. Shkarkimet vazhdojnë të dominohen nga fermentimi enterik, pasi numri i bagëtive ka ndryshime të vogla. Një reduktim modest i atribuohet uljes së përdorimit të uresë. Sektori i PTNPTP-së (përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet) mbetet një burim neto shkarkimesh, në të cilin projektohet një rritje me 8% brenda vitit 2035 krahasuar me vitin 2020, sipas skenarit WEM të PKEK-së, pasi sekuestrimi i karbonit nga pyjet nuk është i mjaftueshëm për të kompensuar shkarkimet nga menaxhimi i pyjeve. Ndonëse zjarret e mëdha në pyje nuk paraqiten drejtpërdrejt në modelin e projeksionit, zona e prekur nga zjarret pritet të rritet me kalimin e kohës.

Shkarkimet nga sektori i mbetjeve projektohen të ulen pas vitit 2025, ulje kjo e nxitur nga përmirësimet në menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe ujërave të ndotura, çka do të rezultojë në një reduktim të përgjithshëm me 33% brenda vitit 2035 krahasuar me vitin 2020. Megjithatë, vijojnë shkarkimet historike nga landfillet ekzistuese. Kalimi nga shkarkimi i drejtpërdrejtë në lumenj tek sistemet e menaxhuara të ujërave të ndotura redukton, gjithashtu, shkarkimet e metanit.

Shkarkimet në sektorin e proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve (PIPP) rriten në mënyrë të qëndrueshme pas vitit 2030, të nxitura kryesisht nga prodhimi i çimentos dhe përdorimi i agjentëve ftohës që zëvendësojnë substancat ozonholluese, të cilat aktualisht janë burimi i dytë më i madh i shkarkimeve në sektorin e PIPP-ve (+34% në vitin 2035 krahasuar me vitin 2020). Nënsektorët e tjerë industrialë kanë kontribut relativisht të ulët.



Figura 3: Projeksioni i shkarkimeve të GES-ve sipas skenarit WEM (burimi: PKEK 2025).

Në **skenarin WAM** (Figura 4), centralet për prodhimin e energjisë së rinovueshme supozohet të funksionojnë me kapacitet të plotë pavarësisht kërkesës së brendshme për energji elektrike, mundësuar kjo nga tregu i energjisë likuide dhe kapacitetet e forta të interkoneksionit. Duke qenë se energjia elektrike e rinovueshme ka kosto operacionale minimale, teprica e energjisë eksportohet, zakonisht pa ndikuar në rezultatet e përgjithshme.

Në sektorin e banesave, shkarkimet projektohen të ulen kryesisht për shkak të aplikimit të gjerë të pompave të nxehtësisë, elektrifikimit të sistemeve të gatimit, si dhe uljes së kërkesës për energji elektrike falë rinovimit të ndërtesave, duke sjellë një ulje me 33% brenda vitit 2035, krahasuar me vitin 2020.

Shkarkimet në sektorin e shërbimeve rriten si përgjigje ndaj rritjes së aktivitetit ekonomik, ndërsa shkarkimet në sektorin e industrisë janë dukshëm më të ulëta se sa në skenarin WEM, gjë e cila pasqyron rritjen e elektrifikimit, zëvendësimin e lëndëve djegëse, si dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë. Në përgjithësi, shkarkimet në sektorin e industrisë projektohen të rriten me 34% në vitin 2035 krahasuar me vitin 2020.

Në sektorin e transportit, shkarkimet mbeten të qëndrueshme deri në vitin 2030, dhe më pas do të ulen gradualisht për shkak të rritjes së elektrifikimit, përdorimit të hidrogjenit dhe zgjerimit të opsioneve të transportit publik për pasagjerët dhe mallrat, çka do të rezultojë në një ulje prej 7% brenda vitit 2035 krahasuar me vitin 2020.

Skenarët WEM dhe WAM ndryshojnë ndjeshëm në *sektorin e PTNPTP-së*. Ndonëse kapaciteti i përgjithshëm i përthithjes mbetet i qëndrueshëm dhe i krahasueshëm mes dy skenarëve, shkarkimet nga menaxhimi i pyjeve ulen ndjeshëm për shkak të përmirësimit të

praktikave të qëndrueshme dhe rritjes së sekuestrimit të karbonit. Si rezultat, shkarkimet projektohen të bien me 41% në vitin 2035 krahasuar me vitin 2020.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm vjen nga industria e çimentos, në të cilën supozohet aplikimi i teknologjisë për kapjen dhe përdorimin e karbonit (CCU). Brenda vitit 2050, këto masa projektohen të reduktojnë me 80% shkarkimet që lidhen me çimenton (ku përfshihen shkarkimet nga proceset dhe djegia).

Sektorët e tjerë shfaqin reduktime mesatare krahasuar me skenarin WEM, sidomos bujqësia, ku shkarkimet ulen me 12% deri në vitin 2035 krahasuar me vitin 2020, për shkak të masave të synuara për reduktimin e metanit nga fermentimi enterik. Strategjia ambicioze për menaxhimin e mbetjeve, e përfshirë tashmë në skenarin WEM, vazhdon të mbështesë reduktimin e shkarkimeve në perspektivën e skenarit WAM.



Figura 4: Projeksioni i shkarkimeve të GES-ve sipas skenarit WAM (burimi: PKEK 2025).

4.4 Veprimet për zbutjen

Përpjekjet për zbutjen në Shqipëri nxiten kryesisht nga karakteristikat operacionale të impianteve të energjisë së rinovueshme, nga reduktimi i përdorimit të lëndëve djegëse fosile në sektorin e transportit dhe atë industrial përmes zëvendësimit të lëndëve djegëse, si dhe nga zbatimi i masave për eficiencën e energjisë që fokusohen te ndërtesat publike dhe private. Për më tepër, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e shkarkimeve.

Politikat strategjike sipas dimensionit të dekarbonizimit fokusohen në arritjen e objektivave të përditësuar kombëtarë që synojnë reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES) dhe rritjen e përqindjes së energjisë së rinovueshme në raport me konsumin final bruto të energjisë. Shqipëria po i jep prioritet zgjerimit të portofolit të saj të energjisë së rinovueshme. Duke qenë se mbështetet fuqimisht në energjinë nga burimet hidrike, vendi po punon në mënyrë aktive për të diversifikuar miksin e burimeve të energjisë, duke zhvilluar projekte për energjinë e erës (eolike), diellore dhe të biomasës.

SKZHIE III adreson, gjithashtu, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe kalimin në një ekonomi me shkarkime të ulëta të karbonit. Siç u konstatua, strategjia njeh kontributin e ulët të Shqipërisë në shkarkimet globale të GES-ve, por angazhohet për të kufizuar më tej shkarkimet, në përputhje me përpjekjet globale. Strategjia i referohet KKP-së së rishikuar të Shqipërisë, duke marrë parasysh periudhën kronologjike midis KKP-së dhe zbatimit fillestar të SKZHIE-së në vitin 2023. Megjithatë, strategjia pasqyron angazhimin ndërkombëtar të vendit sipas Marrëveshjes së Parisit. Dokumenti thekson se plotësimi i këtyre objektivave do të kërkojë

integrimin e plotë të veprimeve për zbutjen në të gjithë sektorët. Në seksionin e ndryshimeve klimatike të SKZHIE III është renditur shprehimisht si objektiv politikash "*ndërmarrja e një sërë masash në nivel kombëtar për uljen e emetimeve* me 20,9% (në bazë të KKP-së së rishikuar) deri në vitin 2030". Më pas, strategjia nënvizon masat zbutëse prioritare, si p.sh. integrimi i masave për zbutjen e GES-ve në buxhetet publike dhe në të gjitha dokumentet strategjike në nivel kombëtar dhe vendor (përkatësisht brenda viteve 2025 dhe 2030). Një tjetër prioritet është garantimi i miratimit të plotë të legjislacionit parësor dhe dytësor në fushën e klimës (harmonizimi me legjislacionin e BE-së për klimën) dhe integrimi i çështjeve klimatike në të gjithë sektorët që preken nga ndryshimet klimatike brenda vitit 2027.

Masat e zbutjes, të paraqitura në këtë seksion, janë ato të përcaktuara në PKEK. KKP-ja bazohet në politikat dhe masat e parashikuara në PKEK, si në skenarin me masat ekzistuese (WEM) ashtu edhe në skenarin me masa shtesë (WAM), të cilat përbëjnë bazën e zbatimit të saj. Për rrjedhojë, masat e identifikuara në PKEK dhe, sipas rastit, në SKZHIE III, janë masat që Shqipëria angazhohet të zbatojë në kuadër të kësaj KKP-je deri në vitin 2035.

Afatet e detajuara të zbatimit, nënobjektivat e kuantifikuar dhe treguesit e monitorimit për secilën masë janë paraqitur në PKEK dhe anekset e tij dhe, për këtë arsye, nuk riprodhohen në mënyrë të plotë në këtë dokument.

Për sa i përket energjisë së rinovueshme, objektivat për vitin 2030 paraqiten në Tabela 2 (burimi: PKEK 2025). Projeksionet për vitin 2035 bazohen në skenarin "me masa shtesë" (WAM) të parashikuar në PKEK 2025, i cili është zgjedhur si bazë për dokumentin aktual të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (KKP).

Tabela 2: Objektivat lidhur me përqindjes e energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme (BRE) në raport me konsumin final bruto të energjisë.

Pjesa e BRE-ve në %[7]	**Viti 2030**	**Viti 2035**
BRE-të në sektorin e transportit	34,8	68,2[8]
BRE-të në sektorin e energjisë elektrike	145,8	147,3
BRE-të në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes	22,6	28,6
BRE-të në konsumin final	59,4	66,7

Zbatimi i masave për eficiencën e energjisë në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë industrinë, ndërtesat rezidenciale dhe transportin, është thelbësor për të reduktuar konsumin e përgjithshëm të energjisë dhe shkarkimet e gazeve me efekt serrë (GES).

Për këtë qëllim, urdhri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 203, datë 18.10.2022, miratoi formatin për planet e veprimit dhe raportet vjetore të progresit për konsumatorët e mëdhenj të energjisë[9]. Në përputhje me parimin e kryerjes së auditimeve të energjisë për konsumatorët e mëdhenj, sidomos në aktivitetet industriale, dhe të promovimit të sistemeve të menaxhimit të energjisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), kjo rregullore synon të garantojë kursime energjie prej të paktën 4% të konsumit total të barasvlershëm të energjisë

[7]Vlerat e BRE-ve që tejkalojnë 100% tregojnë se prodhimi i energjisë së rinovueshme tejkalon konsumin total të energjisë elektrike dhe kjo tepricë eksportohet.

[8] Rritja pothuajse dyfish e pjesës së energjisë nga burimet e rinovueshme në transport ndërmjet viteve 2030 dhe 2035, lidhet me rregullat e kontabilizimit të energjisë së rinovueshme në këtë sektor, ku energjia elektrike nga burime të rinovueshme llogaritet me koeficientë shumëzues. Ky efekt ndikohet edhe nga pjesa e lartë e energjisë së rinovueshme në prodhimin vendas të energjisë elektrike.

[9]Urdhri nr. 203, datë 18.10.2022, "Për miratimin e formatit të planeve të veprimit të konsumatorëve të mëdhenj të energjisë dhe të raportit vjetor të progresit".

për këtë kategori konsumatorësh. Këto plane veprimi janë zhvilluar në bazë të raporteve të auditimit të kryera nga auditues të licencuar të energjisë. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë elektrike, të cilët kanë punësuar menaxherë të certifikuar të energjisë, kanë detyrimin të raportojnë kursimet e tyre të energjisë pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë.

Për më tepër, urdhri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 206, datë 25.10.2022, prezantoi formatin e miratuar të planeve vendore të veprimit për eficiencën e energjisë[10] dhe raportin e progresit për zbatimin e planeve, ndërsa vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 189, datë 5.4.2023, krijoi një platformë monitorimi dhe verifikimi.[11] Këto instrumente synohen të gjurmojnë aktivitetet për eficiencën e energjisë në nivel bashkie dhe do të shërbejnë si kuadër për vlerësimin e progresit kundrejt objektivave kombëtarë për eficiencën e energjisë.

Në sektorin e ndërtesave, aktualisht po zbatohet një paketë e ekuilibruar masash politike për të mbështetur rinovimin e stokut të ndërtesave dhe për të arritur nivelin e specifikuar të rinovimeve. Plani afatgjatë i rinovimit për ndërtesat publike dhe private është në zhvillim e sipër dhe do të përcaktojë masat e nevojshme politike, financiare dhe rregullatore.

Për më tepër, udhëzimi i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 23, datë 17.10.2022, prezantoi një model standard të kontratës për kontraktimin e performancës së energjisë sipas parimit të promovimit të modeleve të Shoqërisë së Shërbimeve Energjetike (ESCO) për të rritur investimet në eficiencën e energjisë.

Në fushën e eficiencës së energjisë është vendosur një objektiv për të reduktuar konsumin final të energjisë brenda vitit 2030 (Tabela 3; burimi: PKEK 2025). Projeksionet për vitin 2035 bazohen në skenarin "me masa shtesë" (WAM) që parashikohet në PKEK 2025, i cili shërben si bazë për dokumentin aktual të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (KKP).

Tabela 3: Objektivat për konsumin final të energjisë.

	Viti 2030	**Viti 2035**
Konsumi final i energjisë (Mtoe)	2,25	2,37

Strategjia Ndërsektoriale e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit (2021–2027)[12], miratuar në vitin 2022, parashikon një qasje gjithëpërfshirëse që integron objektivat për zbutjen e ndryshimeve klimatike në planifikimin sektorial. Komponentët kryesorë të strategjisë që lidhen me zbutjen përfshijnë:

1. Promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore – Nxitja e përdorimit efikas të burimeve dhe adoptimi i teknologjive të gjelbra për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve nga aktivitetet bujqësore.

2. Përmirësimet e përdorimit të tokës dhe restaurimin e ekosistemit – Mbështetja ndaj ripyllëzimit, ruajtjes së tokës dhe përmirësimit të menaxhimit të tokës për të rritur sekuestrimin e karbonit dhe reduktimin e degradimit të tokës.

3. Menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit – Zbatimi i praktikave që parandalojnë mbipeshkimin dhe mbrojnë ekosistemet detare, duke mbështetur kështu biodiversitetin dhe duke kontribuuar në reduktimin e shkarkimeve në sektorin e peshkimit.

Në sektorin e pyjeve dhe të përdorimit të tokës, Shqipëria po investon në projektet e ripyllëzimit dhe pyllëzimit, në kuadër të përpjekjeve të saj për të kompensuar shkarkimet e

[10] Urdhër nr. 206, datë 25.10.2022, "Për miratimin e formatit të planeve vendore të veprimit për eficiencën e energjisë dhe raporti i progresit për zbatimin e planeve".

[11] Vendimet e miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, VKM nr. 189, datë 5.4.2023, "Për miratimin e platformës së monitorimit dhe verifikimit".

[12] VKM nr. 460, datë 29.6.2022, "Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027".

gazeve me efekt serrë. Këto nisma jo vetëm që kontribuojnë në përthithjen e dyoksidit të karbonit, por përmirësojnë, gjithashtu, biodiversitetin dhe mirëqenien e ekosistemit. Vendi po adopton, gjithashtu, praktika të qëndrueshme për përdorimin e tokës dhe po zbaton masa për parandalimin e shpyllëzimit, të cilat janë kritike për ruajtjen e kapaciteteve të përthithjes së karbonit dhe për përmirësimin e qëndrueshmërisë së mjedisit. Në vitin 2018, Shqipëria miratoi dokumentin e politikave për pyjet 2019–2030 përmes VKM-së nr. 814, datë 31.12.2018[13].

Përmes nxitjes së këtyre veprimeve, SKZHIE III njeh rolin e ekosistemeve në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo strategji diskuton rëndësinë e habitateve ligatinore, duke i konsideruar ato si jetike për biodiversitetin e Shqipërisë, pasi përfshijnë afro 70% të specieve të shpendëve, zvarranikëve dhe gjitarëve të vendit, si dhe ofrojnë shërbime si zbutja e rrezikut të përmbytjeve, sekuestrimi i karbonit dhe ekuilibrimi i treguesve klimatikë. Po kështu, menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore përfshin aspektet ekologjike, ndaj vizioni për sektorin e ujit brenda vitit 2030 përfshin përdorimin efikas dhe menaxhimin e integruar që siguron mbrojtjen e mjedisit natyror dhe të biodiversitetit, si dhe përmirësimin e statusit të trupave ujorë, përmes kontrollit të ndotjes dhe reduktimit të luhatjeve.

Në sektorin e mbetjeve, janë adoptuar dhe zbatuar disa masa zbutëse për të reduktuar shkarkimet e metanit (CH_4) nga mbetjet e biodegradueshme. Këto masa përfshijnë integrimin e impianteve të incinerimit të mbetjeve në sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të mbetjeve të Shqipërisë, zgjerimin e impianteve për trajtimin aerobik të ujërave të ndotura dhe të mbulimit të tyre, si dhe ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin institucional, lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe të ujërave të ndotura në nivel bashkie.

Si një vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria po përafron politikat e saj për klimën me rregulloret dhe standardet e BE-së, me qëllimin për të mbështetur tranzicionin e saj të gjelbër. Vendi synon të marrë pjesë në mënyrë aktive në nismat e financuara nga BE-ja, të cilat promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe neutralitetin klimatik. Duke shfrytëzuar mbështetjen financiare dhe asistencën teknike të BE-së, Shqipëria synon të forcojë kapacitetin e saj për zbatimin e projekteve, lidhur me veprimet për klimën dhe të bëjë progres në miratimin e politikave për neutralitetin klimatik.

Tabela 4 ofron një përmbledhje të politikave dhe masave (PM) kryesore që ndikojnë në objektivat kombëtarë për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Përkufizime:

- Politikat dhe masat ekzistuese përfshijnë politikat e zbatuara dhe të miratuara:
- PM-të e zbatuara janë ato për të cilat të paktën një nga kushtet e mëposhtme është përmbushur në datën e dorëzimit të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) ose të raportit të progresit: legjislacioni i detyrueshëm kombëtar ose i BE-së është në fuqi, ekzistojnë marrëveshje vullnetare dhe janë alokuar burimet financiare ose njerëzore.
- PM-të e miratuara janë ato të cilat janë miratuar zyrtarisht nga qeveria në datën e dorëzimit dhe të cilat përmbajnë një angazhim të qartë ndaj zbatimit.
- PM-të e planifikuara janë ato në diskutim e sipër dhe që kanë gjasa reale që të miratohen dhe zbatohen pas datës së dorëzimit.

PM-të kategorizohen sipas dy skenarëve:

- WEM (me masa ekzistuese): Përfshin PM-të e zbatuara dhe të miratuara.
- WAM (me masa shtesë): Përfshin PM-të e planifikuara dhe PM-të e tjera të reja që kanë gjasa reale për t'u zbatuar.

Ndikimi i masave të planifikuara, pra i veprimeve shtesë të propozuara krahas atyre që tashmë janë zbatuar dhe miratuar, vlerësohet të rezultojë në një reduktim total prej 3,2 $MtCO_2eq$ në shkarkimet e gazeve me efekt serrë. Shpërndarja sektoriale e këtij efekti zbutës tregohet në

[13] VKM nr. 814, datë 31.12.2018, "Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030".

figurën 5. Rreth 29% e reduktimit total midis dy skenarëve vjen nga sektori i transportit, 23% nga PTNPTP-ja, 17% nga industria dhe 15% nga PIPP-ja. Kontributi nga sektorët e tjerë është më i vogël dhe varion nga 2% deri në 6%. Sektori i mbetjeve nuk përfshihet në këtë alokim, pasi ndikimi i masave që lidhen me mbetjet pasqyrohet tashmë në skenarin WEM.

Është e rëndësishme të theksohet se efekti zbutës që i atribuohet sektorit të PTNPTP-së në skenarin WAM nuk rezulton nga rritja e thithjes së karbonit nga pyjet. Në fakt, ai pasqyron reduktimin e humbjeve të karbonit të arritur përmes përmirësimit të menaxhimit të pyjeve, promovimit të praktikave të qëndrueshme të përdorimit të tokës dhe parandalimit të shpyllëzimit.



Figura 5: Alokimi sektorial i reduktimeve të projektuara të shkarkimeve nga politikat dhe masat shtesë të planifikuara.

Tabela 4: Përmbledhje e veprimeve kryesore për zbutjen.

Nr.	Kodi i PM-ve	Emri i PM-ve	Lloji i PM-ve	Investime financiare	Alokuar sipas skenarit
1	G-T1	Përmirësimi i linjave të rrjetit të autobusëve ndërurban/ ndërqytetas	Rregullatore	Nuk disponohet buxhet specifik, por buxheti total i parashikuar për investime në sektorin e transportit për një periudhë 20-vjeçare (2019–2038) është 4888,03 milionë euro. Nga këto, 4458,53 milionë euro janë të destinuara për projekte të zhvilluara nga sektori publik, ndërsa 429,5 milionë euro janë investime private. Përllogaritje: 20 000 euro për çdo studim fizibiliteti	WAM
2	G-T2	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave	Rregullatore		WAM
3	G-T3	Nxitja e përdorimit të mjeteve rrugore me emetime të ulëta dhe rinovimi gradual i flotës së transportit	Rregullatore		WEM
4	G-T4	Automjete ekologjike në prokurimin publik	Rregullatore		WAM
5	G-T5	Hidrogjeni ekologjik në transportin me mjete të rënda	Teknike; financiare		WAM

Nr.	Kodi i PM-ve	Emri i PM-ve	Lloji i PM-ve	Investime financiare	Alokuar sipas skenarit
6	G-B1	Politika për nxitjen e përdorimit të BRE-ve në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes	Rregullatore; financiare; edukative	Përllogaritur në 1,6 milion euro për sistemet termike diellore dhe 50 mijë euro për asistencën teknike për përgatitjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor.	WEM
7	G-I1	Zbatimi i ETS-së në Shqipëri	Rregullatore; edukative	2 milionë euro (shifër treguese e bazuar në një analizë krahasuese)	WAM
8	G-I2	Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e Rregullores për Mekanizmat e Monitorimit (MMR)	Rregullatore	1 milion euro.	WEM
9	G-I3	Reduktimi i shkarkimeve të GES-ve nga prodhimi i çimentos	Teknike	Rreth 0,3 milion euro për studimin e fizibilitetit.	WAM
10	G-I4	Reduktimi i shkarkimeve të gazeve të fluorinuara (fazet-F)	Rregullatore; financiare	Rreth 0,5 milion euro.	WAM
11	G-I5	Hidrogjeni ekologjik për industrinë e prodhimit të ferrokromit dhe çelikut	Teknike; Financiare	Përllogaritje: 0,5 milion euro për studimet në nivel strategjik dhe të fizibilitetit.	WAM
12	G-I6	Strategjia e hidrogjenit ekologjik	Promocionale; Rregullatore	Rreth 0,3 milion euro për zhvillimin e strategjisë.	WAM
13	G-A1	Promovimi i bujqësisë organike	Rregullatore; Financiare; Edukative	Buxheti për masat agro-mjedisore, klimatike dhe ato të bujqësisë organike është 2,5 milionë euro pas vitit 2020. Vlera e përllogaritur për trajnimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit është 150 mijë euro.	WEM
14	G-A2	Përmirësimi i monitorimit bujqësor në Shqipëri	Rregullatore	Nuk është identifikuar asnjë buxhet specifik.	WEM
15	G-A3	Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi	Rregullatore; edukative	Nuk është identifikuar asnjë buxhet specifik.	WEM
16	G-W1	Reduktimi i shkarkimeve nga mbetjet	Rregullatore; financiare	Vlera e parashikuar për rehabilitimin e vendgrumbullimit është rreth 76 milionë euro; vlera për grumbullimin e materialeve të riciklueshme të thata rreth 18,5 milionë euro dhe ajo për grumbullimin e mbetjeve organike dhe kompostimin rreth 13 milionë euro (të gjitha vlerat janë llogaritur për periudhën 2018–2032).	WEM
17	G-W2	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri	Rregullatore; financiare	Kostoja e rritjes së ndërgjegjësimit dhe trajnimit është rreth 100 mijë euro.	WEM
18	G-W3	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës	Rregullatore; financiare	Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2019–2030 (draft) ka një kosto prej rreth 1,5 miliardë euro, nga të cilat 99,2% i zë	WEM

Nr.	Kodi i PM-ve	Emri i PM-ve	Lloji i PM-ve	Investime financiare	Alokuar sipas skenarit
				infrastruktura dhe 0,8% asistenca teknike.	
19	G-W4	Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi organizativ për bashkitë, lidhur me trajtimin e mbetjeve dhe ujërave të ndotura	Edukative	Përllogaritur në 150 mijë euro.	WEM
20	G-LF1	Rritja e kapacitetit të sekuestrimit të karbonit në pyje dhe kullota	Rregullatore; financiare; promocionale	Fonde shtetërore në vlerën 6,5 milionë euro (në vit, për sektorin e pyjeve, megjithëse nuk specifikohet nga masat).	WAM
21	G-LF2	Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve	Rregullatore; financiare		WAM
22	R-E1	Mekanizmi i tarifës "*feed-in*" për kapacitetet e vogla të rinovueshme	Rregullatore; financiare	Nuk është parashikuar financim nga buxheti i shtetit, pasi kostoja e skemës do të mbulohej nga tarifat e energjisë elektrike. Megjithatë, ka një ndikim në buxhetin e blerësit, i cili është në pronësi të shtetit.	WEM dhe WAM
23	R-E2	Ankandet për kapacitetet e reja të energjisë së rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe ruajtjen; miratimi i planit trevjeçar të ankandit	Rregullatore; financiare		WEM dhe WAM
24	R-E3	Planifikimi hapësinor për energjinë (zonimi energjetik) për rritjen e përqindjes së energjisë së rinovueshme dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë	Rregullatore; teknike	Rreth 0,5 milion euro.	WAM
25	R-E4	Mekanizmi i matjes së energjisë neto për instalimet deri në 500 kw	Rregullatore	Nuk është parashikuar financim nga buxheti i shtetit, pasi kostoja e skemës do të mbulohej nga tarifat e energjisë elektrike.	WEM
26	R-E5	Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme, investime në kapacitetin e energjisë së rinovueshme në tregun e lirë	Financiare	Sipas disa vlerësimeve paraprake, për rinovimin e rrjetit të shpërndarjes për një përballim më të mirë të injektimit të ndryshueshëm të energjisë së rinovueshme në terma afatshkurtër nevojiten rreth 40 deri në 80 milionë euro investime.	WEM
27	R-E6	Lehtësimi i lidhjes rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik	Rregullatore	Nuk është parashikuar buxhet, pasi bëhet fjalë kryesisht për masa rregullatorë.	WEM
28	R-E7	Menaxhimi i krahut të kërkesës dhe sistemet e rezervave të energjisë elektrike për fleksibilitet të rrjetit elektrik	Rregullatore	Asistenca teknike përllogaritet në 150 mijë euro.	WAM
29	R-E8	Strategjia e matjes dhe digjitalizimi i sektorit të energjisë	Rregullatore	Sipas strategjisë së matjes, investimi afatmesëm i nevojshëm vlerësohet në 3691 milionë lekë (përafërsisht 29,5 milionë euro).	WEM
30	R-E9	Mbështetja për formimin e	Rregullatore.	Programi i Asistencës Teknike,	WAM

Nr.	Kodi i PM-ve	Emri i PM-ve	Lloji i PM-ve	Investime financiare	Alokuar sipas skenarit
		komuniteteve të energjisë së rinovueshme	organizative, promocionale	rreth 150.000 euro. Mbështetja për projektet pilot me komunitetet e përzgjedhura të energjisë së rinovueshme do të financohet nga një Program i Asistencës Teknike, me një buxhet të parashikuar prej 20 000 eurosh për komunitet të energjisë së rinovueshme	
31	R-E10	Pjesëmarrja në një sistem rajonal për garancinë e origjinës (GO)	Rregullatore. organizative	Do të përcaktohet në vazhdim.	WAM
32	R-E11	Hartat e nxehtësisë	Rregullatore; informuese	Përllogaritur në 0,5 milion euro.	WAM
33	R-T1	Elektrifikimi i sektorit të transportit	Rregullatore	Kosto për studimin e vlerësimit të politikave dhe rezultateve vlerësohet në 15 000 euro.	WAM
34	R-T2	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara	Rregullatore;	124 000 euro (*Burimi: Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Shqipëri, 2015–2020*).	WAM
35	R-T3	Instalimi i stacioneve të karikimit për automjetet elektrike dhe instalimi i paneleve fotovoltaike	Financiare	13,5 milionë euro (*IPA III Dritarja 3: Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm*)	WAM
36	R-I1	Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor	Investime, financiare. informative, edukative	Buxheti indikativ: 2 milionë euro.	WAM
37	R-W1	Vlerësimi i përdorimit të energjisë dhe mundësive për zbatimin e burimeve të energjisë së rinovueshme në sektorin e ujit	Investime, financiare	Kostoja e përgjithshme 14,7 milionë euro (*IPA III - 2023 – 2027), Dritarja 3: Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm.*	WAM
38	EE-O1	Skema detyruese e eficiencës së energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	Rregullatore	Duke qenë se ka probleme rregullatore, buxheti lidhet më së shumti me mbështetjen teknike (në bazë të vlerësimit të parë, parashikohen 10–20 mijë euro).	WAM
39	EE-I1	Inspektimi i sistemeve teknike në ndërtesa	Rregullatore; teknike	Pritet vlerësimi i kostove të inspektimit.	WAM
40	EE-L1	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa	Rregullatore	Nuk disponohet një buxhet total i përllogaritur, por disa nga fondet e dedikuara, janë: i. Ndihma shtetërore për "bizneset e reja të gjelbra" në Tiranë, me një vlerë totale të fondit për dy vite prej rreth 0,3 milion euro; dhe ii. 6,5 milionë euro "për eficiencën e energjisë për Qyteti Studenti" nga banka KfW. Ngritja e një baze të dhënash të CPE-së që plotëson kërkesat e ndërveprueshmërisë vlerësohet në	WAM

Nr.	Kodi i PM-ve	Emri i PM-ve	Lloji i PM-ve	Investime financiare	Alokuar sipas skenarit
				0,2 milion euro. Kostoja për funksionimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të CPE-së dhe mjeteve softuerike përkatëse, si dhe për ofrimin e trajnimeve, vlerësohet në 25 000 euro në vit.	
41	EE-L2	Plani afatgjatë i rinovimit të ndërtesave (për ndërtesat publike dhe private) sipas riformulimit të EPBD-së në vitin 2024.	Rregullatore, financiare, informacioni	Vlerësimi fillestar është 1 milion euro.	WAM
42	EE-L3	Standardet minimale të performancës së energjisë për ndërtesat jorezidenciale dhe trajektoret për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave rezidenciale	Rregullatore; teknike		WAM
43	EE-L4	Rikonstruktimi i ndërtesave ekzistuese të qeverisë qendrore *(me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive etj.)*	Investime; rregullatore	Kostot totale të investimit për periudhën 2020–2030 janë 500 milionë euro.	WAM
44	EE-L5	Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike *(të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)*	Investime; rregullatore	Kostot totale të investimit për rikonstruksionin e ndërtesave publike për periudhën 2015–2030 janë 1,8 miliardë euro.	WAM
45	EE-L6	Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e eficiencës së energjisë në ndërtesa (sektori privat)	Financiare	Buxheti për këshillimin falas mbi energjinë/auditimet energjetike që do të financohet nga programet e asistencës teknike është 25 000 euro në vit.	WAM
46	EE-L7	Auditimi i energjisë dhe rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike	Financiare	Pritet vlerësimi i kostove të auditimeve të energjisë.	WAM
47	EE-L8	Programi i rehabilitimit të eficiencës së energjisë në Qytetin Studenti I – Tiranë, Shqipëri – projekt pilot	Financiare	Kostoja e përgjithshme është 42 milionë euro.	WAM
48	EE-S1	Zbatimi i modeleve të Shoqërisë së Shërbimeve Energjetike (ESCO)	Rregullatore; financiare	Përllogaritur në 20 mijë euro.	WAM
49	EE-P1	Masat për eficiencën e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike	Rregullatore	Rreth 50 mijë euro.	WAM
50	EE-P2	Planet bashkiake të veprimit për eficiencën e energjisë, zbatimi dhe raportimi	Rregullatore, edukative	Rreth 6 milionë euro.	WEM
51	EE-P3	Përgatitja e planeve të integruara zhvillimore bashkiake/rajonale të cilat janë të lidhura me PKEK-në	Rregullatore; teknike	Përllogaritur në 0,3 milion euro.	WAM

Nr.	Kodi i PM-ve	Emri i PM-ve	Lloji i PM-ve	Investime financiare	Alokuar sipas skenarit
52	EE-E1	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale	Rregullatore. organizative	Pritet vlerësimi i kostove të auditimeve të energjisë.	WEM
53	EE-E2	Sistemet e menaxhimit të energjisë për NVM-të	Rregullatore. organizative, promocionale	Është përllogaritur një shumë prej 3 milionë euro (duke marrë në konsideratë mbështetjen shumëvjeçare).	WAM
54	EE-C1	Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik	Rregullatore; informative	70 milionë euro.	WAM
55	EE-T1	Etiketimi i energjisë për makinat e reja	Informative; edukative	2 milionë euro.	WAM
56	EE-T2	Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të automjeteve.	Rregullatore. financiare	Rreth 5 milionë euro CAPEX (shpenzime kapitale) në infrastrukturat e stacioneve të karikimit. Pasurimi i flotës së taksive me modele hibride apo elektrike me një kosto kapitale prej 0,5 milion euro.	WAM
57	EE-T3	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike	Rregullatore. financiare	Për të arritur objektivin prej 15,5% për EE-në brenda vitit 2030 është parashikuar një investim prej rreth 228 milionë euro.	WEM
58	EE-T4	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)	Rregullatore	Nuk ka një vlerë të vetme, pasi ekzistojnë disa projekte që lidhen me ndërhyrje të ndryshme për sistemin e transportit. Durrës–Tiranë–Rinas, 129 milionë euro.	WEM
59	EE-T5	Përmirësimi i rrjetit të transportit hekurudhor që lidh Shqipërinë me rrjetin ndërkombëtar të transportit hekurudhor	Rregullatore; financiare	Do të përcaktohet në vazhdim.	WEM dhe WAM

4.5 Financimi i përllogaritur për masat zbutëse

Ky seksion parashikon nevojat e përllogaritura për investim dhe financim të identifikuara në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) 2025, të Shqipërisë. Vlerësimet buxhetore të paraqitura shërbejnë si një udhëzues i përgjithshëm për të mbështetur planifikimin dhe zbatimin e detajuar të politikave dhe masave (PM) individuale.

Në përputhje me konceptin e kostove të transaksionit në teorinë ekonomike, vlerësimet/përllogaritjet përfshijnë, gjithashtu, kostot fillestare të nevojshme për të mundësuar investimin e suksesshëm. Këtu përfshihen shpenzimet për zhvillimin strategjik, studimet teknike dhe financiare të fizibilitetit, ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e stafit, përgatitjen e udhëzimeve, si dhe aktivitetet e tjera përgatitore që janë thelbësore për arritjen e rezultateve të synuara të çdo PM-je. Kostot faktike ndryshojnë në varësi të fushës së çdo veprimi, ekspertizës së përfshirë (kombëtare ose ndërkombëtare) dhe disponueshmërisë së burimeve ekzistuese, si p.sh. udhëzimet e zhvilluara paraprakisht për prokurimin publik me në fokus eficiencën e energjisë.

Nevojat e përllogaritura për investim lidhur me veprimet për zbutjen në PKEK kapin vlerën e afro 2,6 miliardë eurove sipas skenarit "me masa ekzistuese" (WEM), dhe një vlerë shtesë prej 6,9 miliardë euro sipas skenarit "me masa shtesë" (WAM).

Këto shuma përfaqësojnë nevojat totale të investimeve që duhen mobilizuar nga burime publike, private dhe donatore, dhe nuk përbëjnë një angazhim të pakushtëzuar për financim publik. Objektivi i zbutjes së KKP-së në vetvete është i pakushtëzuar, arritja e tij mbështetet, por nuk varet nga mobilizimi i këtyre nevojave financiare.

Në tabelën 4 më sipër është paraqitur një analizë e detajuar e buxhetit dhe nevojave për investim, sipas politikave dhe masave.

5. PËRSHTATJA

Ndryshimet e projektuara të temperaturës, reshjeve dhe rritjes së nivelit të detit (shihni seksionin 5.2 më poshtë) do të ndikojnë në çdo rajon të Shqipërisë dhe në çdo sektor socio-ekonomik në një mënyrë specifike, në varësi të karakteristikave individuale.

Ky kapitull, i cili ka në fokus përshtatjen, është plotësisht i harmonizuar me draftin përfundimtar të Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP, qershor 2026–2036) së Shqipërisë, dhe fokusohet në sektorët prioritarë: bujqësia, pyjet dhe kullotat, turizmi, energjia, transporti dhe zhvillimi urban. Këta sektorë janë thelbësorë për ekonominë e Shqipërisë, duke mbështetur jetesën, infrastrukturën dhe burimet natyrore. PKP-ja thekson cenueshmëritë në këto fusha, sidomos në zonën bregdetare, e cila përfshin një pjesë të konsiderueshme të popullsisë dhe të infrastrukturës kryesore, si dhe është një destinacion kryesor turistik. Me qëllim përmirësimin e planifikimit të përshtatjes, rekomandohet një bazë e centralizuar e të dhënave klimatike në nivel kombëtar, për t'u dhënë akses grupeve të interesit në të dhëna, projeksione dhe masa, si dhe për të orientuar ndërhyrjet e donatorëve. Gjithashtu, mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë për ndikimet klimatike kërkon integrimin në mënyrë formale të perspektivës gjinore dhe përmirësimin e mbledhjes së të dhënave, në veçanti lidhur me cenueshmëritë e grave.

Duke u mbështetur në seksionin 3, "Për rrethanat kombëtare", ky seksion mbi përshtatjen është strukturuar, si në vijim:

- Seksioni 5.1 paraqet sektorët prioritarë;
- Seksioni 5.2 paraqet ndryshueshmërinë e klimës dhe ndryshimet në Shqipëri, në lidhje me temperaturën, reshjet dhe rritjen e nivelit të detit;
- Sektori 5.3 analizon rreziqet, ndikimet dhe cenueshmërinë nga ndryshimet klimatike për gjashtë sektorët prioritarë; *dhe së fundi*
- Seksioni 5.4 kategorizon dhe prioritizon masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

5.1 Sektorët prioritarë – Konteksti

5.1.1 Bujqësia

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë socio-ekonomikë të ekonomisë shqiptare dhe një nga sektorët që konsiderohen më të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Bujqësia vazhdon të luajë një rol qendror në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare. Sipas Treguesve të Zhvillimit Botëror të Bankës Botërore, sektori kontribuoi me rreth 16,2% të PBB-së në vitin 2023, ndërsa në vitin 2024, kjo përqindje pësoi një rënie të lehtë në 15,5%. Njëkohësisht, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), raportoi, përmes ILOSTAT-it dhe të dhënave të shpërndara nga Treguesit e Bankës Botërore, se në vitin 2023, bujqësia kontribuoi në rreth 34,9% të totalit të punësimit. Këto shifra konfirmojnë se pesha e bujqësisë në punësim mbetet e lartë në mënyrë joproporcionale krahasuar me kontributin e saj në PBB, gjë që thekson rëndësinë e saj të vazhdueshme për jetesën rurale dhe sigurinë ushqimore, pavarësisht faktit se ekonomia e Shqipërisë po orientohet gjithnjë e më shumë drejt sektorit të shërbimeve.

Temperaturat më të ngrohta kanë ndikuar tashmë negativisht në zonat fushore për shkak të rritjes së kërkesës për ujë dhe stresit nga nxehtësia tek kulturat bujqësore, por kanë zgjatur periudhën e sezonit të kultivimit në zonat kodrinore dhe malore. Temperaturat më të larta gjatë

periudhës së verës dhe reshjet më të ulëta kanë ndikuar tashmë në sistemet e kullotjes ku ka mundësi të kufizuara lidhur me përshtatjen. Sektori ndahet në këto zona agro-ekologjike (ZAE): i. zonat fushore; ii. zonat e ndërmjetme kodrinore; iii; zonat malore veriore dhe qendrore; si dhe iv. malësia jugore. Nënsektorët përfshijnë: kulturat e përkohshme bujqësore, kulturat e përhershme bujqësore, gjedhët dhe kuajt, derrat dhe shpendët, si dhe delet dhe dhitë. Këshillat e përshtatura sipas sektorit dhe perspektivat sezonale që vijnë nga përmirësimi i shërbimeve klimatike, të kombinuara me masat e hershme të bazuara në rrezik dhe projektet pilot të PbE-së në zonat e ujitura/bregdetare, mbështesin drejtpërdrejt prodhimin e qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike dhe jetesën rurale.

5.1.2 Pylltaria dhe kullotat

Pylltaria dhe kullotat mbulojnë afërsisht 1.9 milion hektarë (66% të territorit të Shqipërisë), nga të cilët 1.1 milion hektarë janë pyje dhe 0.8 milion hektarë janë kullota dhe livadhe. Sektori ofron shërbime kritike të ekosistemit (rregullimi i tokës dhe ujit, ruajtja e biodiversitetit, sekuestrimi i karbonit) dhe mbështet jetesën rurale përmes drurit, kullotjes dhe produkteve pyjore jodrusore. Pylltaria dhe kullotat rregullohet nga Ligji për Pyjet dhe Kullotat (nr. 5/2016) dhe Strategjia Kombëtare për Pyjet dhe Kullotat 2019–2030. Rreziqet kryesore klimatike përfshijnë zjarret në pyje, shpërthimet e dëmtuesve, kullotjen e tepërt, speciet pushtuese dhe rrëshqitjet e tokës të shkaktuara nga reshjet. Sektori ofron bashkëpërfitimet më të larta të zbutjes nga të gjithë sektorët e përshtatjes (>300,000 tCO_2e/vit).

5.1.3 Turizmi

Sektori i turizmit mund të ndikohet pozitivisht dhe negativisht nga ndryshimet klimatike të projektuara. Për shkak të periudhave të ngrohta më të gjata, turizmi i "diellit dhe detit" që mbizotëron në zonën bregdetare mund të zgjatet përtej muajve të njohur të korrikut dhe gushtit. Megjithatë, bazuar në këto kushte dhe në kuadër të përgatitjes për një numër më të madh turistësh dhe një qëndrimi më të gjatë të turistëve, kostoja e ndërtimit të strukturave turistike do të rritet, ku përfshihet energjia elektrike për ngrohje dhe ftohje, mbrojtja ndaj motit ekstrem dhe ambientet rekreative. Faktorët që mund të ndikojnë në tërheqjen e turistëve ndaj bregdetit shqiptar për shkak të efekteve të ndryshimeve klimatike përfshijnë humbjen e zonave të plazhit për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe erozionit, dëmtimin e trashëgimisë kulturore dhe shkatërrimin e biodiversitetit, si dhe të peizazheve natyrore detare dhe bregdetare. Nënsektorët përfshijnë diellin dhe detin, turizmin ekologjik, qytetet dhe artin, si dhe trashëgiminë kulturore. Paralajmërimet e hershme lidhur me të nxehtin, stuhitë dhe rreziqet bregdetare, si dhe zgjidhjet buferike të bazuara në natyrë dhe udhëzimet për mbrojtjen nga ndryshimet klimatike, të zhvilluara përmes një platforme kombëtare për informacionet rreth klimës, reduktojnë rreziqet operacionale për destinacionet dhe asetet.

5.1.4 Energjia

Rritja e kërkesës për ftohje, e nxitur nga rritja e PBB-së, e ka kaluar pikun e konsumit të energjisë te muajt e verës, një tendencë kjo që pritet të intensifikohet.

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e saj të Veprimit 2020–2030 (2019)[14] vlerësojnë se, brenda vitit 2050, prodhimi mesatar vjetor i energjisë elektrike nga hidrocentralet e mëdha në Shqipëri mund të reduktohet me rreth 15% dhe nga hidrocentralet e vogla me rreth 20%. Rritja e temperaturave do të ndikojë realisht disa nënsektorë të ndryshëm të energjisë për shkak të rritjes së nevojave për ftohje dhe faktorëve të tjerë që lidhen me klimën (nënsektorët e energjisë përfshijnë naftën, gazin dhe qymyrin; energjinë hidrike; lëndët drusore si lëndë djegëse; energjinë eolike dhe diellore, si dhe transmetimin dhe shpërndarjen).

5.1.5 Transporti

[14] Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit.

Sektori i transportit, i përbërë nga transporti detar, ajror, hekurudhor dhe rrugor, është rritur me ritme të shpejta që nga viti 2000, sidomos për sa i përket numrit të mjeteve në rrugë dhe infrastrukturës së transportit. Sektori i transportit është shkarkuesi më i madh i gazeve me efekt serrë në Shqipëri. Ndryshimet klimatike ndikojnë te sektori i transportit në shumë mënyra, sidomos përmes motit ekstrem, si p.sh.: shirat e rrëmbyeshëm, stuhitë dhe era ekstreme, stuhitë detare, përmbytjet ose valët e të nxehtit. Këto kanë ndikim në infrastrukturën e transportit, si dhe në besueshmërinë dhe sigurinë e transportit. Nënsektorët përfshijnë transportin rrugor, transportin hekurudhor, transportin detar dhe transportin ajror.

5.1.6 Zhvillimi urban

Ndikimet e ndryshimeve klimatike në zonat urbane janë tejet të larta për shkak të përqendrimit të popullsisë dhe aseteve, sidomos në zonat me rrezik të lartë, dhe kushteve që përshkallëzojnë rreziqet (si p.sh.: rritja e rrjedhjeve sipërfaqësore si rezultat i uljes së përshkueshmërisë së dheut, rritja e nivelit të detit dhe depërtimi i tij, efektet e ishujve të nxehtësisë urbane). Në Tiranë, infrastruktura e transportit, energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë, si dhe industria e vogël, janë tejet të cenueshme nga reshjet e dendura dhe përmbytjet. Përqindja e popullsisë që banon në zonat urbane pritet të shkojë në 78,2% brenda vitit 2050. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT, 2016) përfaqëson një përpjekje të koordinuar për planifikimin e territorit dhe do të formësojë ndjeshëm trajektoren e ardhshme të zhvillimit urban të Shqipërisë. Ky plan gjithëpërfshirës propozon ndërhyrjet dhe modelet e mëposhtme për qendrat urbane: Konsolidimi dhe rigjenerimi (metropolet, qendrat kryesore urbane); Përforcimi dhe rigjenerimi (qendrat kryesore urbane terciare); Fuqizimi dhe rigjenerimi (qytetet hyrëse dhe qendrat lindore urbane); Bashkëpunimi (komunitetet).

Zonat klimatike përfshijnë zonën mesdhetare fushore (ZMF), zonën mesdhetare kodrinore (ZMK), zonën mesdhetare paramalore (ZMPM) dhe zonën mesdhetare malore (ZMM). Nënsektorët përfshijnë rrjetet rezidenciale, sociale, të prodhimit dhe të furnizimit.

5.2 Ndryshueshmëria e klimës dhe ndryshimet klimatike

Projeksionet e ndryshimeve klimatike të paraqitura në këtë dokument bazohen në një grup skenarësh të zhvilluar nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK), në kuadër të Raportit të Gjashtë të Vlerësimit (RV6, 2022), duke përdorur të dhëna nga faza e 6-të e Projektit të Ndërkrahasimit të Modeleve të Çiftuara të Klimës (PNMÇK6). Skenarët e përdorur janë trajektoret e përbashkëta socio-ekonomike (TPS):

- TPS1-1.9 (shkarkime të ulëta, zhvillim i qëndrueshëm);
- TPS2-4.5 (skenari mesatar); si dhe
- TPS5-8.5 (shkarkime të larta, zhvillimi me lëndë djegëse fosile).

Këta skenarë përdoren gjerësisht sepse ata përfaqësojnë një gamë parashikimesh të besueshme, duke filluar nga ato optimiste, e deri tek ato mesatare e pesimiste, për t'u mundësuar kërkuesve dhe politikëbërësve që të vlerësojnë ndikimet e ndryshimeve klimatike, nevojat për përshtatje dhe strategjitë për zbutjen në nivele të ndryshme të ngrohjes globale. Periudha referencë për projeksionet është 1986–2005.

Një përshkrim i shkurtër i pesë trajektoreve të përbashkëta socio-ekonomike (TPS) jepet më poshtë:

- TPS1: Qëndrueshmëria: Burimet e përbashkëta globale po ruhen: kufijtë e sistemeve natyrore po respektohen dhe fokusi është te mirëqenia e njerëzve dhe jo vetëm te rritja ekonomike. Pabarazitë në të ardhura midis vendeve dhe brenda tyre po reduktohen. Modelet e konsumit po orientohen drejt minimizimit të përdorimit të burimeve materiale dhe energjisë.
- TPS2: Skenari mesatar: Zhvillimi drejt së ardhmes: Trajektoret e të ardhurave mes vendeve po ndryshojnë ndjeshëm. Ndonëse ekziston një nivel i caktuar bashkëpunimi mes shteteve, fushëveprimi i tij mbetet i kufizuar. Rritja e popullsisë në nivel global është në nivele mesatare

dhe do të vijë duke u stabilizuar në gjysmën e dytë të shekullit. Sistemet mjedisore po përjetojnë një shkallë degradimi.

- TPS5: Zhvillimi me lëndë djegëse fosile: Tregjet globale po bëhen gjithnjë e më të integruara, duke nxitur novacionin dhe përparimet teknologjike. Megjithatë, zhvillimi social dhe ekonomik varen shumë nga shfrytëzimi i intensifikuar i burimeve të lëndëve djegëse fosile, ku qymyri përbën një përqindje të konsiderueshme, si dhe karakterizohet nga një stil jetese me konsum intensiv energjie që mbizotëron në mbarë globin. Ndërsa ekonomia botërore vazhdon të zgjerohet, problemet mjedisore në nivel vendor, si p.sh. ndotja e ajrit, po adresohen me efikasitet.

5.2.1 Temperatura

Të dhënat për temperaturën që prej vitit 1951 tregojnë se temperaturat mesatare vjetore të sipërfaqes në Shqipëri kanë qenë në pjesën më të madhe të shekullit ndërmjet 11°C dhe 12°C. Që nga viti 1998, mesatarja e rrumbullakosur ka qenë mbi 12°C dhe ka vazhduar qartësisht në rritje, duke arritur mesatarisht në 12,72°C në vitin 2016 (figura 6).

Tendencat e projektuara tregojnë se temperatura mesatare vjetore në Shqipëri do të rritet nga 0,8°C deri në 1°C brenda vitit 2030 dhe nga 0,9°C deri në 2°C brenda vitit 2050, krahasuar me periudhën referencë 1986–2005. Rritjet më të konsiderueshme do të ndodhin midis periudhës qershor–shtator. Në bregdetin shqiptar parashikohet që temperaturat mesatare vjetore të rriten për të gjitha stinët. Në muajt e verës, temperaturat maksimale do të rriten nga 1,5°C deri në 6,4°C brenda vitit 2100. Në muajt e dimrit, temperaturat minimale mund të rriten nga 0,9°C deri në 3,8°C.



Figura 6: Temperatura mesatare në sipërfaqe (°C), në Shqipëri (1950–2020)
Burimi: Grupi i njohurive mbi ndryshimet klimatike, 2021.

Shpeshtësia e temperaturave ekstremisht të larta pritet të rritet, pasi projektohet, gjithashtu, një ulje e ndjeshme e periudhave të kthimit të temperaturave maksimale. Numri i netëve tropikale (>20°C), gjithashtu, projektohet të rritet. Për pasojë, numri dhe kohëzgjatja e valëve të të nxehtit pritet të rritet. Numri mesatar i valëve të të nxehtit për çdo vit projektohet të rritet me 3–4 herë brenda periudhës 2030–2050 në të gjithë skenarët.

5.2.2 Reshjet

Nivelet mesatare të reshjeve kanë mbetur relativisht të qëndrueshme që nga 1901, edhe pse me një tendencë të lehtë në rënie. Reshjet në Shqipëri priten të ulen nga 2,4% deri në 5,8% brenda vitit 2050 krahasuar me periudhën referencë 1986–2005.

Viti



Figura 7: Reshjet mesatare (mm) në Shqipëri (1950–2020)
Burimi: Grupi i njohurive mbi ndryshimet klimatike, 2021

Reshjet vjetore në bregdetin shqiptar pritet të ulen nga 1,6 deri në 2,9% brenda vitit 2050 dhe nga 1,6% deri në 7,1% brenda vitit 2100. Parashikohet se reshjet do të pësojnë rënien më të lartë gjatë muajve të verës (8,7% deri në 38,1% brenda vitit 2100). Megjithatë, parashikohet se reshjet do të rriten gjatë muajve të dimrit, nga 1,8% deri në 3,2% brenda vitit 2050 dhe nga 1,8% deri në 7,8% brenda vitit 2100. Duke pasur parasysh temperaturat më të ngrohta, kjo rritje e nivelit të reshjeve nënkupton se ato do të jenë në formën e shirave dhe jo të dëborës, çka do të shkaktojë rritje të prurjeve të lumenjve gjatë dimrit dhe ulje të prurjeve gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës.

Ndryshueshmëria e reshjeve pritet të rritet në zonën bregdetare të Shqipërisë, si dhe parashikohet të rritet shpeshtësia dhe intensiteti i ngjarjeve me reshje të dendura shiu. Periudhat e kthimit për ditët me reshje >100 mm projektohen të ulen me 15,9–16,7 vite brenda vitit 2050. Gjatë muajve të verës, rritja e rasteve me reshje të dendura shiu kombinuar me rënien e nivelit mesatar të reshjeve tregon se shpeshtësia e thatësirave pritet të rritet. Pritet një reduktim i madh i reshjeve në nivelin e percentilit 5%.

5.2.3 Rritja e nivelit të detit

Një tendencë në rritje është konstatuar mes viteve 1993 dhe 2004. Kjo tendencë është pasuar nga një periudhë trevjeçare gjatë së cilës anomalia e rritjes së nivelit të detit shfaqi rënie, përpara se të regjistronte sërish një rritje mesatare mes viteve 2007 dhe 2015 (Baastel, 2024a). Niveli i detit projektohet të rritet me 11 cm brenda vitit 2030 dhe me 20–28 cm brenda vitit 2050 në të gjithë skenarët.



Figura 8: Anomalia e nivelit të detit (mm) në Shqipëri (1993–2015)
Burimi: Grupi i njohurive mbi ndryshimet klimatike, 2021

5.3 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria nga ndryshimet klimatike

Shqipëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve gjeologjike (tërmetet, rënia e shkëmbinjve), por edhe ndaj rreziqeve hidro-meteorologjike, si përmbytjet (vërshimet dhe rrëshqitjet e dheut që lidhen me to), thatësirat dhe zjarret në pyje janë më të shpeshtat (përgjegjëse për mbi 90% të dëmeve).

Rrëshqitjet e dheut klasifikohen tashmë si hidro-meteorologjike dhe jo gjeologjike për shkak të lidhjes së fortë me nivelin e reshjeve. Rrëshqitjet e dheut të shkaktuara nga tërmetet vijojnë të klasifikohen si gjeologjike.

Popullsia kryesisht rurale e Shqipërisë është tejet e cenueshme ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ku ngjarjet ekstreme të reshjeve shpesh rezultojnë në përmbytje shkatërrimtare. Zonat urbane dhe industritë ndikohen nga përmbytjet dhe valët e të nxehtit, ndërsa periudhat e thatësirave kërcënojnë furnizimin me ujë të pijshëm. Ndërsa temperaturat rriten, skenarët klimatikë parashikojnë një rritje të ashpërsisë dhe shpeshtësisë së këtyre kushteve ekstreme të motit të nxehtë, të lagësht dhe të thatë, shoqëruar nga një ulje e totalit të reshjeve vjetore. Kjo e vendos në rrezik popullsinë e Shqipërisë dhe përbën një kërcënim sidomos për bujqësinë, energjinë hidrike, industritë turistike dhe qendrat urbane. Duke marrë parasysh ndikimin e drejtpërdrejtë që kanë thatësirat mbi bujqësinë, si dhe pamundësinë e interpretimit të informacioneve rreth klimës për të rritur gatishmërinë, është thelbësore të përmirësohet më tej parashikimi i informacioneve rreth klimës për të kuptuar se kur duhet racionuar uji gjatë sezonit të thatësirave. E njëjta logjikë vlen edhe për parashikimin dhe prodhimin e energjisë për hidrocentralet në mënyrë që të mos tejkalohet prodhimi gjatë sezoneve me reshje të luhatshme.

Indeksi i Vendeve i Nismës Globale të Përshtatjes Notre Dame mat cenueshmërinë dhe gatishmërinë ndaj rreziqeve dhe krizave, në rang global, për të gjitha vendet. Në vitin 2024, Shqipëria u rendit e 63-ta (nga 180 vendet e vlerësuara), me një pozicion vulnerabiliteti prej 69 dhe 62 për gatishmërinë). Krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian, Shqipëria paraqet një performancë më të dobët në aspektin e përshtatjes klimatike dhe renditet pas disa vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ndryshimet klimatike pritet të rrisin shpeshtësinë dhe kohëzgjatjen e ngjarjeve ekstreme klimatike, duke përforcuar ekspozimin e vendit ndaj rreziqeve natyrore. Vetëm përmbytjet dhe tërmetet pritet të shkaktojnë dëme mesatare vjetore prej rreth 147 milionë dollarësh amerikanë në Shqipëri, sipas vlerësimit të Bankës Botërore për financimin e rrezikut nga fatkeqësitë për Shqipërinë (2020).

Pritet që kjo shifër të vazhdojë të rritet në vitet në vijim. Kufizimi i ndikimit të këtyre efekteve tek ekonomia dhe zhvillimi i vendit kërkon kapacitete dhe burime financiare, të cilat për momentin janë të pamjaftueshme. Për të realizuar një planifikim efikas të përshtatjes është thelbësore të ekzistojë një bazë e qëndrueshme të dhënash për ndikimin sektorial.

Rreziqet aktuale në të gjithë sektorët u matën për aspektet në vijim: rritja e temperaturës, intensiteti i reshjeve dhe rritja e nivelit të detit (RrND); Rreziqet e ardhshme u fokusuan te rritja e temperaturës, ulja e reshjeve, RrND-ja dhe thatësirat. Kjo rezultoi në vlerësimet e kombinuara të rrezikut në vijim për sektorët e ndryshëm dhe për nënsektorët e tyre të identifikuar.

5.3.1 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e bujqësisë

Ndonëse shqetësimet rreth rreziqeve aktuale në sektorin e bujqësisë janë të përziera, rreziqet e ardhshme janë seriozisht shqetësuese dhe madje alarmante në rastin e skenarit më të keq në të ardhmen. Zonat fushore janë ZAE-ja me rrezik shumë të lartë në të tashmen dhe të ardhmen, dhe pasohet nga ZAE-ja e zonave të ndërmjetme kodrinore që renditet e dyta për sa i përket nivelit të rrezikut. Zonat malore veriore dhe qendrore përbëjnë ZAE-në me rrezikun më të ulët. Kjo ZAE mund të përfitojë nga sezonet më të gjata të kultivimit për kulturat bujqësore të verës dhe dimrit, të cilat mund të kompensojnë rritjen e kërkesës për ujë dhe stresin nga nxehtësia që priten gjatë muajve të verës. Megjithatë, në terma afatgjatë, ky përfitim mund të kërcënohet sërish nga rritja e vazhdueshme e kërkesës për ujë dhe e stresit nga nxehtësia. Sipas nënsektorëve, kulturat bujqësore janë më të rrezikuarat, si në të tashmen po ashtu edhe në

projeksionet për të ardhmen, në varësi të llojit të kulturës, RrND-së dhe periudhës, dhe rreziqet rriten ndjeshëm në skenarin më të keq. Përgjithësisht, kulturat e përkohshme bujqësore janë më të rrezikuarat, sidomos në terma afatshkurtër. Në nënsektorët e bagëtive, rreziqet variojnë nga të ulëta e deri në shumë të larta. Gjedhët dhe kuajt janë më të rrezikuarit, rrezik ky që bëhet shumë i lartë në rastin e skenarit klimatik më të keq. Derrat, shpendët, delet dhe dhitë kanë vlerësime rreziku më të ulëta, dhe në rastin e skenarit më të keq niveli i rrezikut është mesatar (tabela 5).

Tabela 5: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e bujqësisë

ZAE-të dhe nënsektorët e bujqësisë	Rreziku i përgjithshëm aktual	Rreziku i ardhshëm (skenari më i mirë/më i keq)
ZAE		
Zonat fushore	Shumë i lartë	Shumë i lartë
Zonat e ndërmjetme kodrinore	I lartë	I lartë – shumë i lartë
Zonat malore veriore dhe qendrore	I ulët	I ulët – mesatar
Malësia jugore	Mesatar	Mesatar – i lartë
NËNSEKTORËT		
Kulturat e përkohshme bujqësore	I lartë	Shumë i lartë
Kulturat e përhershme bujqësore	Mesatar	Mesatar – shumë i lartë
Gjedhët dhe kuajt	Mesatar	I lartë – shumë i lartë
Derrat dhe shpendët	I ulët	I ulët – mesatar
Delet dhe dhitë	I ulët	I ulët – mesatar

5.3.2 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e pylltarisë dhe kullotave

Rreziqet kryesore të përbashkëta dhe specifike, përfshijnë:

- Frekuencë dhe intensitet më të lartë të zjarreve në pyje dhe rrezikut të zjarreve në kullota për shkak të thatësirave të zgjatura dhe valëve të nxehtësisë;
- Prodhim i reduktuar i foragjereve dhe cilësi ushqyese në kullota, duke çuar në humbje të produktivitetit të bagëtive;
- Shpërthime më të larta të dëmtuesve dhe sëmundjeve në pyje, dhe zgjerim të specieve pushtuese si në pyje ashtu edhe në kullota;
- Erozion të tokës dhe rrëshqitje të dheut në shpatet e shpyllëzuara ose të mbikullotura, të përkeqësuara nga reshjet intensive;
- Shkallë të reduktuara të rritjes dhe tharje të specieve të pemëve dhe bimësisë së kullotave të ndjeshme ndaj thatësirës.
- Ndryshimi në përbërjen e specieve dhe humbja e pyjeve të lartësisë së madhe dhe kullotave alpine. Rreziku aktual është i moderuar në të lartë. Rreziku i ardhshëm përshkallëzohet ndjeshëm në të lartë ose shumë të lartë nën shumicën e skenarëve, veçanërisht në zonat fushore, bregdetare dhe kodrinore. Sektori LULUCF (i cili përfshin pyjet dhe kullotat) aktualisht mbetet një burim neto i shkarkimeve; shkarkimet nga degradimi dhe zjarret parashikohet të rriten duke mos pasur menaxhim të qëndrueshëm dhe të përmirësuar. Zjarret në shkallë të gjerë, megjithëse nuk modelohen drejtpërdrejt në parashikimet e shkarkimeve, përfaqësojnë një kërcënim të madh në zhvillim.

5.3.3 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e turizmit

Vlerësimet e rrezikut për sektorin e turizmit përshkallëzohen nga rreziqet aktuale në rreziqet e ardhshme, dhe madje në rastin e skenarit më të keq arrijnë deri në nivele alarmante. Sipas nënsektorëve, më i rrezikuari është turizmi ekologjik, ndërsa në rastin e skenarëve më të mirë, më pak të rrezikuara janë qytetet dhe arti, dhe segmentet e trashëgimisë kulturore. Megjithatë "më pak të rrezikuara" nuk do të thotë "jo të rrezikuara", pasi, për shembull, rritja e projektuar

e nivelit të detit ka potencialin që të dëmtojë ndjeshëm plazhet dhe akomodimet turistike në bregdet (turizmi i diellit dhe detit), qytetet bregdetare (turizmi urban) dhe sitet e trashëgimisë kulturore në zonat bregdetare (turizmi kulturor). Disa dallime në vlerësimet e rrezikut mund të shpjegohen përmes mënyrës se si kanë përfituar nënsektorët nga zhvillimi i vazhdueshëm në Shqipëri dhe se si pritet të përfitojnë më tej nga zhvillimi i ardhshëm (tabela 6).

Tabela 6: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e turizmit

Nënsektorët e turizmit	Rreziku i përgjithshëm aktual	Rreziku i ardhshëm (skenari më i mirë/më i keq)
Dielli dhe deti	I ulët	I lartë – shumë i lartë
Turizmi ekologjik	Mesatar	Shumë i lartë – shumë i lartë
Qytetet dhe arti	I ulët	Mesatar - i lartë
Trashëgimia kulturore	Mesatar	Mesatar – shumë i lartë

5.3.4 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e energjisë

Vlerësimet e rrezikut për energjinë përshkallëzohen nga rreziqet aktuale në rreziqet e ardhshme, duke arritur në nivele të konsiderueshme në rastin e skenarit më të keq. Ndonëse shqetësimet mbi rreziqet aktuale mund të jenë të ulëta e deri në mesatare, rreziqet e ardhshme janë alarmante, sidomos në skenarin më të keq, i cili lidhet fort me rënien e nivelit të disponueshmërisë së ujit. Më të rrezikuarit janë nënsektori i transmetimit dhe shpërndarjes, nënsektori i lëndëve drusore si lëndë djegëse dhe nënsektori i energjisë hidrike. Më pak i rrezikuari është nënsektori i energjisë eolike dhe diellore, ndonëse deri më tani ai përbën një përqindje shumë të vogël në prodhimin e energjisë (tabela 7).

Tabela 7: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e energjisë

Nënsektorët e energjisë	Rreziku i përgjithshëm aktual	Rreziku i ardhshëm (skenari më i mirë/më i keq)
Nafta, gazi dhe qymyri	Shumë i ulët	Mesatar – shumë i lartë
Energjia hidrike	I ulët	Mesatar – shumë i lartë
Lëndët drusore si lëndë djegëse	I ulët	Mesatar – shumë i lartë
Energjia eolike dhe diellore	Shumë i ulët	I ulët – mesatar
Transmetimi dhe shpërndarja	Mesatar	Mesatar – shumë i lartë

5.3.5 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e transportit

Vlerësimet e rrezikut për transportin përshkallëzohen nga rreziqet aktuale në rreziqet e ardhshme, duke arritur deri në nivele të konsiderueshme në rastin e skenarit më të keq, dhe madje disa rreziqe kategorizohen si alarmante. Një faktor i rëndësishëm që rezultoi në vlerësime rreziku shumë të larta në skenarin më të keq është rritja e projektuar e reshjeve intensive dhe dëmet që ato mund të sjellin në nënsektorët e transportit (sidomos në transportin rrugor dhe hekurudhor) përmes erozionit, përmbytjeve dhe rrëshqitjeve të dheut. Përveç reshjeve intensive, temperatura mesatare vjetore dhe nxehtësia ekstreme vlerësohet se ndikojnë kryesisht te nënsektorët e transportit hekurudhor dhe transportit detar, ndërsa rritja e projektuar e nivelit të detit ndikon kryesisht në nënsektorin e transportit detar. Sipas nënsektorëve, transporti rrugor, transporti hekurudhor dhe transporti detar janë më të rrezikuarit, ndërsa nënsektori i transportit ajror është më pak i rrezikuari. Megjithatë, nënsektori i transportit hekurudhor përbën një përqindje shumë të vogël të transportit të përgjithshëm (tabela 8).

Tabela 8: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e transportit

Nënsektorët e transportit	Rreziku i përgjithshëm aktual	Rreziku i ardhshëm (skenari më i mirë/më i keq)
Transporti rrugor	I ulët	Mesatar – shumë i lartë
Transporti hekurudhor	I ulët	I ulët – shumë i lartë
Transporti detar	Shumë i ulët	Mesatar – shumë i lartë
Transporti ajror	Shumë i ulët	I ulët – mesatar

5.3.6 Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e zhvillimit urban

Në të katër zonat klimatike urbane, parashikohet rritje e rreziqeve aktuale në të ardhmen. Pjesa më e madhe e rreziqeve kategorizohen si "Shumë të larta" si në skenarin më të mirë po ashtu edhe në skenarin më të keq. Në veçanti, qytetet më të populluara (Tirana, Durrësi, Vlora, Fieri, Shkodra, Elbasani) dhe zona më e urbanizuar e vendit (brezi bregdetar), kanë vlerësime të rrezikut të ardhshëm të kategorizuara si "Shumë të larta". Qytetet e tjera kanë rreziqe të ardhshme "Të larta" sipas skenarit më të mirë dhe "Shumë të larta" sipas skenarit më të keq. Për të gjithë nënsektorët urbanë (nënsektori rezidencial, social, i prodhimit dhe rrjeti i furnizimit), në të ardhmen projektohet një rritje e rreziqeve duke kaluar në kategorinë "Rreziqe shumë të larta". Në basenet e ekspozuara ndaj përmbytjeve, këtu përfshihen stacionet funksionale të paralajmërimit të hershëm, informimi i komunitetit dhe planet bashkiake të evakuimit që lidhen me restaurimin e shtratit të lumenjve dhe fushave aluvionale (tabela 9).

Tabela 9: Rreziqet, ndikimet dhe cenueshmëria në sektorin e zhvillimit urban

Zonat klimatike urbane dhe nënsektorët	Rreziku i përgjithshëm aktual	Rreziku i ardhshëm (skenari më i mirë/më i keq)
ZONAT KLIMATIKE		
ZMF	I ulët	Shumë i lartë – shumë i lartë
ZMK	I ulët	Shumë i lartë – shumë i lartë
ZMPM	I ulët	I lartë – shumë i lartë
ZMM	I ulët	I lartë – shumë i lartë
NËNSEKTORËT		
Rezidencial	I lartë	Shumë i lartë – shumë i lartë
Social	I lartë	Shumë i lartë – shumë i lartë
Prodhimi	I ulët	Shumë i lartë – shumë i lartë
Rrjeti i furnizimit	I ulët	Shumë i lartë – shumë i lartë

Për ta përmbledhur, sektori urban, i bujqësisë dhe i turizmit vlerësohen si më të rrezikuarit, ndërsa sektori i energjisë dhe i transportit vlerësohen si më pak të rrezikuar (si për rreziqet aktuale po ashtu edhe për ato të ardhshme). Arsyeja kryesore është ndjeshmëria që ka bujqësia dhe turizmi ndaj ndryshimeve në variablat klimatikë, ndërsa në rastin e sektorit urban, arsyeja kryesore është ndjeshmëria e këtij sektori ndaj rritjes së temperaturave dhe valëve të të nxehtit, duke pasur parasysh efektin e ishujve të nxehtësisë urbane, si dhe përqendrimin e konsiderueshëm të sektorit urban në bregdet. Për sa i përket rreziqeve të ardhshme, më të rrezikuarit janë nënsektorët që lidhen me kulturat e përkohshme bujqësore, turizmin ekologjik dhe zhvillimin urban. Nënsektorët më pak të rrezikuar janë derrat dhe shpendët, delet dhe dhitë, energjia eolike dhe diellore, të cilat kanë të gjitha rrezik mesatar.

Rreziqet klimatike ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe kombinimi i tyre, i cili krijon të ashtuquajturat rreziqe të përbëra ose komplekse, mund të ketë efekte më të rënda se sa kur këto

rreziqe shfaqen më vete. Gjithashtu, sektorët dhe nënsektorët janë të ndërlidhur; rreziqet në një sektor nënkuptojnë rreziqe për sektorët e tjerë. Shqipëria është e ekspozuar, gjithashtu, edhe ndaj rreziqeve klimatike ndërkufitare, pra ndaj rreziqeve të lidhura me ndryshimet klimatike që kanë ndikim te rrjetet dhe burimet e përbashkëta me vende të tjera, në veçanti në sektorët e turizmit, transportit dhe energjisë. Nëse rreziqet e përbëra ose ndërkufitare merren parasysh, rreziqet klimatike të Shqipërisë mund të klasifikohen vetëm si të larta ose shumë të larta.

Ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë në rritjen e rreziqeve të përgjithshme klimatike të Shqipërisë. Faktorët që e bëjnë vendin tejet të cenueshëm janë sipërfaqja e vogël, përqendrimi i popullsisë në zonat bregdetare, shpyllëzimi dhe zjarret në pyje, si dhe varësia e madhe ndaj turizmit të diellit dhe detit, transportit rrugor dhe energjisë hidrike.

Grupet e cenueshme, sidomos gratë dhe komunitetet e margjinalizuara në zonat e ekspozuara ndaj përmbytjeve, përballen me ndikime joproporcionale për shkak të moshës, gjendjes shëndetësore, statusit ekonomik, ose vendndodhjes. Megjithatë, ende nuk ka të dhëna konkrete mbi ndikimet e ndara sipas gjinisë.

Njerëzit që jetojnë në lagje të margjinalizuara, shpesh në zona të ekspozuara ndaj përmbytjeve përgjatë shtretërve të lumenjve, dhe në zonat bregdetare, janë veçanërisht të rrezikuar ndaj valëve të të nxehtit dhe reshjeve të dendura të shiut. Gjithashtu, gratë priren të jenë më të cenueshme ndaj rreziqeve klimatike krahasuar me burrat. Duke mos pasur sisteme të mbrojtjes sociale që të integrojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe rrjeteve të sigurisë, ndryshimet klimatike mund të bëjnë që, në këto komunitete të cenueshme, të kalohen pragjet kritike nga të cilat nuk ka më kthim pas. Menaxhimi i papërshtatshëm mjedisor, ku përfshihet shpyllëzimi, menaxhimi i dobët i pellgjeve ujëmbledhëse dhe menaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve, rrit, gjithashtu, rreziqet klimatike në të gjithë sektorët. Gjithashtu, mangësitë në legjislacionin për klimën, kapacitetet njerëzore, të dhëna dhe pajisje, mund të përkeqësojnë më tej rreziqet klimatike të vendit dhe përpjekjet për përshtatje.

Nga ana tjetër, disa faktorë mund të reduktojnë rreziqet klimatike të Shqipërisë. Larmia e konsiderueshme e ekosistemeve të saj dhe relievi i thyer i bregdetit të Jonit, kontribuojnë në qëndrueshmërinë e vendit. Për më tepër, rritja e projektuar e PBB-së dhe PBB-së për frymë do të rrisë kapacitetin e përshtatjes së vendit. Zbatimi i rregulloreve, strategjive dhe planeve evropiane kontribuon në një integrim më të mirë të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, në rritjen e kapacitetit të përshtatjes së vendit dhe në reduktimin e rreziqeve klimatike.

5.4 Masat e përshtatjes

Për të pestë sektorët prioritarë, është përgatitur një grup i masave të përshtatjes, si dhe i masave ndërsektoriale, në bazë të masave ose veprimeve të përshtatjes të identifikuara tashmë në kuadrin përkatës të politikave të Shqipërisë, të cilat janë diskutuar dhe analizuar më tej me ekspertët sektorialë.

Janë identifikuar tre fusha kryesore të përgjithshme ndërsektoriale për masat e përshtatjes, si më poshtë:

i. Përmirësimi i koordinimit mbi ndryshimet klimatike (me 4 masa specifike të përshtatjes);

ii. Krijimi i një baze të centralizuar të dhënash në nivel kombëtar për t'u siguruar grupeve të interesit akses në projeksionet klimatike dhe në masat e përshtatjes, me qëllim adresimin e mangësive në të dhënat për ndikimet sektoriale; si dhe

iii. Përshtatja e bazuar në ekosistem dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë.

Është propozuar një përmirësim në nivel kombëtar, i orientuar drejt shërbimeve, i funksioneve meteorologjike dhe hidrologjike për të rritur cilësinë dhe përdorueshmërinë e të dhënave për vendimmarrjen në të gjithë sektorët prioritarë. Objektivi kombinon:

- Forcimin e shërbimeve kombëtare hidro-meteorologjike në nivel institucional dhe rregullator;

- Modernizimi i rrjeteve vëzhguese, menaxhimit të të dhënave dhe kontrollit të cilësisë (duke përfshirë lidhjet me protokollet e shkëmbimit ndërkombëtar);

- Ndërtimi i një kuadri kombëtar për shërbimet klimatike me një sistem kombëtar të informacioneve rreth klimës dhe një platformë me ndërfaqe për përdoruesin, për të zhvilluar bashkërisht me përdoruesit shërbime të përshtatura sipas sektorit.

Së bashku, këto masa rrisin besueshmërinë e vëzhgimeve dhe parashikimeve, mundësojnë grupe konsistente të dhënash klimatike dhe krijojnë mundësi për këshilla të synuara për bujqësinë, energjinë, transportin, turizmin dhe planifikimin urban. Duke u mbështetur në përmirësimin e shërbimeve klimatike dhe hidrometeorologjike, kjo qasje do të lehtësonte krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për shumë rreziqeve që mbulon përmbytjet, thatësirat, stuhitë, valët e të nxehtit, rrëshqitjet e dheut dhe zjarret në pyje. Duke qartësuar kompetencat mes autoriteteve përgjegjëse për klimën, aspektet hidrologjike dhe mbrojtjen civile, duke aplikuar flukse pune gjithëpërfshirëse për zbulimin dhe monitorimin, duke garantuar dhënien e paralajmërimeve të dokumentuara dhe në kohë, si dhe duke integruar protokollet e gatishmërisë, sistemi do të kalonte nga shërbimet e dhënies së informacionit mbi rreziqet te shërbimet e bazuara në ndikim, të cilat reduktojnë humbjet dhe mbrojnë mjetet e jetesës në të gjithë sektorët.

Masat e identifikuara në <u>sektorin e bujqësisë</u> ndahen në nëntë nënkategori, si në vijim:

i. Të përgjithshme (4 masa specifike të përshtatjes);

ii. Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave (5 masa specifike të përshtatjes);

iii. Menaxhimi i zjarreve (3 masa specifike të përshtatjes);

iv. Ruajtja e kulturave bujqësore, si dhe e burimeve gjenetike blegtorale, specieve dhe racave vendase (6 masa specifike të përshtatjes);

v. Promovimi i varieteteve të qëndrueshme/rezistente ndaj të nxehtit, thatësirave dhe kripës (2 masa specifike të përshtatjes);

vi. Menaxhimi i specieve invazive për bujqësinë dhe pyjet (3 masa specifike të përshtatjes);

vii. Mbrojtja e tokës bujqësore nga përmbytjet si pasojë e rritjes së nivelit të lumenjve dhe detit (4 masa specifike të përshtatjes);

viii. Menaxhimi i pjellorisë së tokës (7 masa specifike të përshtatjes); si dhe

ix. Vlerësimi i ujit që përdoret në sektorin e bujqësisë dhe i masave të eficiencës së ujit (8 masa specifike të përshtatjes).

Masat e identifikuara në <u>sektorin e pylltarisë dhe kullotave</u> ndahen në katër nënseksionet e mëposhtme:

i. Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave (5 masa specifike të përshtatjes);

ii. Menaxhimi i zjarreve (3 masa specifike të përshtatjes);

iii. Menaxhimi i specieve pushtuese për pylltarinë dhe kullotat (pjesa specifike për pylltarinë dhe kullotat e 3 masave origjinale, plus çdo masë shtesë e identifikuar gjatë konfirmimit nga palët e interesuara);

iv. Masa të tjera ndërsektoriale që synojnë posaçërisht qëndrueshmërinë e pyjeve dhe kullotave (p.sh.: restaurimi i kullotave të degraduara, integrimi i agropylltarisë, planet e kullotjes së qëndrueshme dhe rritja e sekuestrimit të karbonit në peizazhet pyjore dhe kullotave).

Për <u>sektorin e turizmit</u> masat e identifikuara ndahen, si më poshtë:

i. Të përgjithshme (4 masa specifike);

ii. Ndërtesa dhe infrastruktura ekzistuese rezistente ndaj ndryshimeve klimatike (4 masa specifike);

iii. Rivendosja e një brezi të gjelbër përgjatë bregdetit për të mbrojtur tokën nga erozioni dhe për qëllime rekreative (5 masa specifike);

iv. Menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga turizmi (5 masa specifike); *si dhe*

v. Masa që përfshijnë zonat malore (4 masa specifike).

Për sektorin e energjisë masat e identifikuara ndahen, si më poshtë:

i. Të përgjithshme (2 masa specifike);

ii. Mobilizimi i burimeve për zbatimin e planit të eficiencës së energjisë (8 masa specifike);

iii. Kompostimi, duke përfshirë rikuperimin e energjisë nga mbetjet bujqësore – biomasa (3 masa specifike); si dhe

iv. Vlerësimi i prodhimit dhe konsumit të energjisë (6 masa specifike).

Për sektorin e transportit masat e identifikuara ndahen, si më poshtë:

i. Të përgjithshme (6 masa specifike);

ii. Diversifikimi i sektorit të transportit (5 masa specifike); si dhe

iii. Masa të tjera (2 masa specifike).

Për sektorin e zhvillimit urban masat e identifikuara ndahen, si më poshtë:

i. Të përgjithshme (4 masa specifike);

ii. Ndërtesa dhe infrastruktura ekzistuese rezistente ndaj ndryshimeve klimatike (4 masa specifike);

iii. Promovimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë në mjediset urbane (5 masa specifike).

Për të përkthyer planifikimin në veprime të frytshme, nevojitet një qasje holistike për të integruar sektorin privat, përkatësisht zhvillimin e ekosistemeve novatore që shërbejnë si katalizator për shërbimet klimatike në sektorin privat. Për më tepër, për shkak të mungesës së financimit për masat e përshtatjes, është parashikuar një kornizë e posaçme financimi për aspektet klimatike për të përshkallëzuar projektet e suksesshme pilot të PbE-ve/ZbN-ve dhe për të mbledhur bashkëfinancime. Diçka e tillë do të forconte lidershipin e vendit, do të rriste kthimin nga investimet për përshtatjen dhe do të ndërlidhte masat vendore me objektivat kombëtarë.

Masat/veprimet e mëposhtme të përshtatjes janë identifikuar gjatë zhvillimit të Planeve Vendore të Përshtatjes në 8 fusha për periudhën 2022–2024, të renditura sipas bashkisë dhe llojit të veprimeve të përshtatjes (tabela 10).

Tabela 10: Masat e përshtatjes sipas bashkisë

Bashkia/lloji dhe numri i masave të përshtatjes	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastër	Krujë	Kukës	Përmet	Vlorë	TOTALI
Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe ndërtimet	32	26	15	17	15	15	18	21	159
Infrastruktura	21	17	11	10	10	16	10	12	107
Biznesi dhe industria	31	14	12	12	8	18	14	13	122
Mjedisi natyror	31	10	7	10	7	16	16	16	113
Asetet dhe operacionet bashkiake	17	11	10	11	10	3	12	11	85
Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi	14	15	4	13	13	13	13	12	97
TOTALI	**146**	**93**	**59**	**73**	**63**	**81**	**83**	**85**	**683**

Mesatarisht janë identifikuar rreth 85 masa përshtatjeje për çdo bashki (numri më i madh i masave në Durrës dhe më i ulëti në Fier), ku vendin e parë e zënë masat për "*njerëzit, shëndetin, komunitetet dhe ndërtesat*", pasuar nga masat që lidhen me "*biznesin dhe industrinë*" në vend të dytë, "*mjedisi natyror*" në vend të tretë dhe "*Infrastruktura*" në vend të katërt. Masat e përshtatjes lidhur me "*qeverisjen, monitorimin dhe vlerësimin*" dhe "*asetet dhe operacionet bashkiake*" kanë numrin më të ulët.

66 masat e përshtatjes të përfshira në këtë KKP pasqyrojnë një analizë me shumë kritere (AShK) të realizuar sipas procesit të PKP-së së Shqipërisë dhe të validuar me grupet e interesit

në nivel kombëtar. Masat u renditën mes kritereve të fizibilitetit, harmonizimit dhe përfitimeve. Masat me nivel prioriteti "Shumë të lartë" dhe "Të lartë" kalojnë në fazën e zbatimit; lista përfundimtare përbëhet nga masa në fushat në vijim: bujqësia/pyjet (21), turizmi (11), zhvillimi urban (9), energjia (8), transporti (7) dhe ndërhyrjet ndërsektoriale (10). Për sa i përket masave infrastrukturore të gjelbra/gri, të cilat kërkojnë investime të mëdha, u krye një analizë kosto-përfitimi (CBA) për një nëngrup prej 21 masash, duke përdorur të dhëna kombëtare për kostot të validuara me ekspertët sektorialë. Kur ka qenë e nevojshme, janë përdorur të dhëna nga sistemi i informacionit gjeografik (GIS), ndërsa për të llogaritur përfitimet janë përdorur vlerat rajonale referencë. Analiza, e cila buron nga Plani Kombëtar i Përshtatjes, raporton vlerën aktuale neto (NPV) dhe raportet kosto-përfitim, si dhe përfshin teste të ndjeshmërisë; rezultatet e detajuara paraqiten në dokumentet informuese të masave të PKP-së dhe informojnë fazat e investimeve dhe menaxhimin e rrezikut të përshkruar këtu. Vlerat kryesore të Vlerës Aktuale Neto dhe intervalet e raportit përfitim-kosto, kriteret dhe peshat e plota të analizës me shumë kritere, si dhe institucionet përgjegjëse kryesore, afatet kohore dhe treguesit e rezultateve për secilën masë, janë përcaktuar në Planin Kombëtar të Përshtatjes 2026–2036, të miratuar në qershor 2026[15].

Vlerësimet e kostove për masat e përshtatjes, me vlerë totale prej 9,8 miliardë dollarë (afërsisht 8,4 miliardë euro, 2026–2036) janë përftuar nga PKP-ja, si dhe janë krahasuar me PKEK-në për të garantuar përputhshmërinë. Këto vlerësime përfshijnë kostot e zbatimit të drejtpërdrejtë dhe kostot e transaksioneve (p.sh.: zhvillimi i strategjisë, studimet e fizibilitetit, ngritja e kapaciteteve). Për shkak të mungesës së kostove të detajuara në shumë strategji sektoriale, metodologjitë mbështeten te konsultimet me ekspertët, të dhënat historike të projekteve dhe vlerat referencë të kostove të harmonizuara me BE-në. Burimet e detajuara dhe supozimet janë dokumentuar në shtojcat e PKP-së (korrik 2024) dhe PKEK-së (2025) për të mbështetur Ministrinë e Financave në planifikimin e buxhetit dhe për të lehtësuar proceset e miratimit.

Masat kategorizohen si: të buta, të gjelbra, ose gri.

- **Masat e buta** përfshijnë ndërhyrjet jostrukturore që synojnë përmirësimin e njohurive, qeverisjes dhe gatishmërisë. Shembujt përfshijnë hulumtimet dhe vlerësimet e rrezikut, instrumentet politike dhe rregullatore, ngritjen e kapaciteteve, mjetet financiare, planifikimin hapësinor strategjik, infrastrukturën rezistente ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe planet e përgjigjes ndaj emergjencave;
- **Masat e gjelbra** janë zgjidhje të bazuara në natyrë që shfrytëzojnë ekosistemet për të reduktuar rreziqet klimatike dhe për të siguruar përfitime të përbashkëta, si përmirësimi i biodiversitetit dhe sekuestrimi i karbonit. Shembujt përfshijnë: ripyllëzimin, restaurimin e ekosistemeve, praktikat e agropylltarisë, zgjidhjet bioinxhinierike, rivendosjen e korridoreve të gjelbra, mbrojtjen e habitateve dhe parandalimin e erozionit dhe të përmbytjeve;
- **Masat gri** konsistojnë në zgjidhjet inxhinierike ose teknologjike të projektuara për të reduktuar ekspozimin fizik ndaj rreziqeve klimatike. Shembujt përfshijnë infrastrukturat e qëndrueshme, si p.sh.: strukturat valëthyese dhe barrierat kundër përmbytjeve, sistemet e paralajmërimit të hershëm, përmirësimet në infrastrukturën energjetike, sistemet e ujitjes, rikonstruktimin e strukturave të energjisë hidrike, si dhe infrastrukturat turistike rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.

Masat ndërsektoriale

1. Forcimi i qëndrueshmërisë rajonale: Ofrimi i mbështetjes për Udhërrëfyesin e Ballkanit Perëndimor për Përshtatjen me Klimën (masë e butë, 315 000 USD, 2026–2027).

[15] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 10.6.2026, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike, 2026–2036".

2. Optimizimi i koordinimit për çështjet klimatike: Forcimi i kuadrit të GNPNK-së (masë e butë, 420 000 USD, 2026–2027).

3. Përmirësimi i kapaciteteve për përshtatjen: Ofrimi i mbështetjes për Grupin Teknik dhe Grupin Drejtues për Ndryshimet Klimatike (masë e butë, 745 000 USD, 2026–2028).

4. Përmirësimi i qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet sistemeve të përmirësuara të të dhënave (masë e butë, 1 500 000 USD, 2026–2027).

5. Zgjidhjet e bazuara në natyrë dhe skemat e zhvillimit për përmirësimin neto të biodiversitetit (masë e gjelbër, 242 793 396 USD, 2026–2030).

6. Zhvillimi i rritjes së ndërgjegjësimit dhe trajnimit për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatikë (masë e butë, 1 500 000 USD, 2026–2027).

7. Mekanizmat novatorë të financimit për klimën: Pilotimi i strategjive të financimit të qëndrueshëm (masë e butë, 6 080 000 USD, 2026–2027).

8. Pilotimi i vlerësimeve të menaxhimit të rrezikut për bizneset e qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatikë (masë e butë, 200 000 USD, 2026–2027).

9. Promovimi i përshtatjes me ndjeshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike: Trajnimi i grupeve të interesit (masë e butë, 143 000 USD, 2026–2027).

10. Edukimi i komuniteteve: Rritja e ndërgjegjësimit për përshtatjen dhe fatkeqësitë (masë e butë, 3 025 000 USD, 2026–2027).

Masat për bujqësinë

11. Fuqizimi i fermerëve: mbështetje financiare për infrastrukturën e qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatikë (masë e butë, 29 600 000 USD, 2026–2027).

12. Mbrojtja e fermerëve: Programe kompensimi dhe asistence për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë (masë e butë, 102 250 000 USD, 2026–2027).

13. Plan veprimi për speciet invazive sipas kushteve klimatike të ndryshueshme (masë e butë, 160 000 USD, 2026–2027).

14. Forcimi i mbrojtjes ndaj përmbytjeve: Rehabilitimi i shtratit të lumenjve dhe zgjerimi i fushave aluvionale (masë gri, 179 022 000 USD, 2029–2038).

15. Zbatimi i zgjidhjeve për krijimin e habitateve dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të luftuar erozionin e tokës (masë e gjelbër, 41 787 500 USD, 2026–2030).

16. Përmirësimi i kapaciteteve të IGJEO-s për monitorimin bregdetar (masë e butë, 322 200 USD, 2026–2027).

17. Zgjerimi dhe modernizimi i sistemeve të ujitjes (masë gri, 249 123 998 USD, 2033–2042).

18. Siguri e qëndrueshme e burimeve ujore përmes infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të shiut (masë gri, 75 849 163 USD, 2029–2038).

Masat për pylltarinë dhe kullotat

19. Përmirësimi i efikasitetit të pyjeve përmes pajtueshmërisë me rregulloret e BE-së (masë e butë, 17 600 000 USD, 2026–2027).

20. Avancimi i pylltarisë së qëndrueshme: Fonde për pyllëzimin dhe nisma për prokurimet e gjelbra (masë e butë, 8 540 000 USD, 2026–2027).

21. Rivitalizimi i tokave të dëmtuara: Integrimi i Zgjidhjeve të bazuara në Natyrë (NbS) dhe Përshtatjes së bazuar në Ekosisteme (EBA) me Agropylltarinë (masë e gjelbër, 1,494,738,115 USD, 2026–2035).

22. Forcimi i mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave (masë e butë, 475 000 USD, 2026–2027).

23. Avancimi i pyllëzimit: Krijimi i fidanishteve rajonale (masë e gjelbër, 2 249 360 USD, 2026–2027).

24. Ofrimi i mbështetjes për migrimin e specieve pyjore të rralla dhe endemike (masë e gjelbër, 894 780 USD, 2029–2033).

25. Rehabilitimi i ekosistemeve jetike: Mbrojtja e brezave të gjelbër bregdetarë dhe lumorë (masë e gjelbër, 145 561 688 USD, 2029–2033).

26. Financime të qëndrueshme përmes pagesës për shërbimet e ekosistemit (masë e butë, 16 000 000 USD, 2026–2027).

27. Restaurimi i integruar i ekosistemeve dhe rritja e reziliencës: Adresimi i erozionit të tokës (masë e gjelbër, 62,573,351 USD, 2029–2033).

28. Parandalimi i erozionit dhe përmbytjeve: Restaurimi strategjik i habitateve (masë e gjelbër, 124,943,176 USD, 2029–2033).

29. Menaxhimi i qëndrueshëm i peizazheve: Përmirësimi i cilësisë së ujit në Liqenin e Viroit (masë e gjelbër, 479,334 USD, 2029–2033).

30. Përmirësimi i qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatikë në parqet kombëtare (masë e gjelbër, 257 461 805 USD, 2026–2035).

31. Rivendosja e shtresave pyjore për mbrojtjen e kulturave bujqësore në Vlorë (masë e gjelbër, 3,282,947 USD, 2029–2033).

Masat për turizmin

32. Planifikimi hapësinor strategjik për turizmin: Riorientimi i zhvillimit (masë e butë, 600 000 USD, 2026–2027).

33. Infrastruktura turistike rezistente ndaj ndryshimeve klimatike: Paketa nxitëse (masë e butë, 800 000 USD, 2026–2027).

34. Planifikimi strategjik për qëndrueshmërinë bregdetare: Zona buferike dhe kanale detare (masë e butë, 504 000 USD, 2026–2027).

35. Mbrojtja e Gjirit të Vlorës: Ruajtja e habitateve me bimë Posidonia (masë e gjelbër, 3 606 119 USD, 2029-2033)

36. Forcimi i kuadrit të politikave dhe kuadrit rregullator për turizmin e qëndrueshëm (masë e butë, 120 500 USD, 2026–2027).

37. Integrimi i të dhënave klimatike për turizmin e qëndrueshëm (masë e butë, 290 000 USD, 2026–2027).

38. Infrastruktura turistike rezistente ndaj ndryshimeve klimatike: Projektet përshtatëse (masë gri, për t'u konfirmuar, 2029–2033).

39. Mbrojtja e zonave bregdetare: Integrimi i rregulloreve (masë e butë, 657 000 USD, 2026–2027).

40. Ngritja e kapaciteteve për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike: Trajnimi i operatorëve turistikë (masë e butë, 430 000 USD, 2026–2027).

41. Qendra digjitale për turizmin e qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike (masë e butë, 34 000 USD, 2026–2027).

42. Mbrojtja e aseteve turistike: Zbatimi i rregulloreve (masë e butë, 1 450 000 USD, 2026–2027).

Masat për zhvillimin urban

43. Planifikimi detar dhe territorial për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike (masë e butë, 290 000 USD, 2026–2027).

44. Planifikimi hapësinor strategjik për zvogëlimin e rrezikut (masë e butë, 3 027 000 USD, 2026–2027).

45. Skema nxitëse për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj temperaturave ekstreme (masë e butë, 2 715 000 000 USD[16], 2032–2036).

[16] Ky është një program kombëtar stimulues financiar për stokun e ndërtesave dhe masa më e madhe e vetme e përshtatjes, e cila shpjegon koston e saj të lartë; instrumentet financiare klasifikohen si 'të buta'. Sipas PKP-së (2026–2036), është planifikuar si një masë afatgjatë (fillimi 2032–2036), në përputhje me kulmin e disbursimit në vitet 2033–2035, të shënuar më poshtë në tabelën 11.

46. Integrimi i hapësirave të gjelbra në infrastrukturën publike (masë e butë, 380 000 USD, 2026–2027).

47. Restaurimi i korridoreve të gjelbra: Ripyllëzimi dhe gjelbërimi urban (masë e gjelbër, 568 544 USD, 2026–2027).

48. Vlerësimi i rreziqeve klimatike për Durrësin, Elbasanin, Fierin dhe më gjerë (masë e butë, 196 000 USD, 2026–2027).

49. Planet e emergjencës në rastet e përmbytjeve (masë e butë, 2 500 000 USD, 2026–2027).

50. Përmirësimi i qëndrueshmërisë urbane: Vlerësimi i hapësirave të gjelbra (masë e gjelbër, për t'u konfirmuar, 2026–2027).

51. Projekte të qëndrueshme urbane: Ruajtja e zonave të depërtimit (masë e butë, 1 200 000 USD, 2026–2027).

Masat për energjinë

52. Mbrojtja e infrastrukturës energjetike kundër erërave të forta (masë gri, 986 298 000 USD, 2026–2027).

53. Përmirësimi i efikasitetit të ndërtesave: Certifikatat e performancës së energjisë (masë e butë, 3 500 000 USD, 2026–2027).

54. Eksplorimi i potencialit të sektorit të energjisë: Menaxhimi i kërkesës (masë e butë, 2 900 000 USD, 2026–2027).

55. Mbrojtja e infrastrukturës energjetike: Monitorimi i zonave të emergjencës (masë e butë, 875 000 USD, 2026–2027).

56. Përmirësimi i qëndrueshmërisë ndaj valëve të të nxehtit përmes teknologjisë efikase të ajrit të kondicionuar (masë e butë, 38 200 000 USD, 2026–2027).

57. Optimizimi i energjisë së rinovueshme për sistemet e qëndrueshme (masë e butë, 176 850 000 USD, 2026–2027).

58. Rritja e barazisë gjinore në sektorin e energjisë: Trajnime për gratë (masë e butë, 4 900 000 USD, 2026–2027).

59. Rritja e qëndrueshmërisë në fushën e energjisë hidrike: Optimizimi i operacioneve (masë gri, 747 050 000 USD, 2026–2027).

Masat për transportin

60. Analiza të rregullta për cenueshmërinë dhe rrezikun, lidhur me infrastrukturën rrugore (masë e butë, 457 000 USD, 2026–2027).

61. Studime gjeologjike për rrugët e qëndrueshme: Zgjidhje bioinxhinierike (masë e butë, 2 900 000 USD, 2026–2027).

62. Përmirësimi i lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme dhe me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike (masë e butë, 1 200 000 USD, 2026–2027).

63. Përshtatja e infrastrukturës kritike të transportit (masë e butë, 2 700 000 USD, 2026–2027).

64. Integrimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë për qëndrueshmërinë e sektorit të transportit (masë e gjelbër, 2 029 460 000 USD, 2026–2027).

65. Politika për transportin e qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike (masë e butë, 218 000 USD, 2026–2027).

66. Partneritete novatore për transportin e qëndrueshëm (masë e butë, 1 900 000 USD, 2026–2027).

Zbatimi planifikohet për periudhën 2026–2036, në përputhje me ciklet kombëtare të miratimit. Korniza 10-vjeçare akomodon ngritjen e kapaciteteve, realizimin e infrastrukturës dhe monitorimin e bazuar në komente. Parashikohet të kryhet një rishikim i strukturuar afër fundit të periudhës për të çuar përpara masat në proces dhe për t'u përshtatur ndaj rreziqeve të reja, në përputhje me alokimin buxhetor të paraqitur këtu. Progresi në drejtim të përshtatjes do të gjurmohet duke përdorur një grup konciz treguesish (si p.sh. norma e zbatimit të masave të

planifikuara, shtrirja kohore e rishikimeve të planit) dhe treguesit në nivel mase, sipas rastit. Analiza më shumë kritere e PKP-së vlerësoi qartësisht çdo masë lidhur me barazinë gjinore dhe përfitimet për grupet e cenueshme (gratë, të rinjtë, komunitetet e margjinalizuara), duke garantuar që prioritetet e caktuara të promovojnë qëndrueshmërinë e drejtë dhe shpërndarjen e barabartë të përfitimeve. Këto perspektiva do të ruhen përgjatë zbatimit dhe monitorimit.

Cikli i monitorimit dhe vlerësimit mbështet përditësimet periodike të planit për të pasqyruar ndryshimet rregullatore, institucionale dhe socio-ekonomike, duke garantuar që komponenti i KKP-së për përshtatjen të mbetet i zbatueshëm dhe aktual. Burimi i investimit kombinon burimet e brendshme publike me financimet e jashtme koncesionare dhe kapitalin privat, duke shfrytëzuar instrumentet e identifikuara në PKP (zërat e buxhetit publik, programet e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe pjesëmarrja e sektorit privat/PPP-ve) me pika hyrëse të përshtatura sipas sektorit. Ky model i grumbullimit të fondeve plotëson alokimin buxhetor (2026–2036) dhe përforcohet nga evidencat e CBA-së për opsionet e infrastrukturës prioritare. Përvoja nga përgatitja e PKP-së thekson rëndësinë e harmonizimit të prioriteteve vendore afatshkurtra me objektivat kombëtarë afatgjatë (duke përfshirë me raportimin në kuadër të KKKBNK-së) dhe të zhvillimit të treguesve të prekshëm, të cilët mund të gjurmohen nga bashkitë me kapacitetet ekzistuese. Përfshirja e këtyre mësimeve në zbatim, monitorim dhe vlerësim do të përmirësojë lidershipin dhe efikasitetin. Në Raportin e ardhshëm Dyvjeçar të Transparencës (BTR) dhe në Planin Kombëtar të Përshtatjes 2026–2036, Shqipëria synon të kryejë hartëzimin e këtyre treguesve të përshtatjes kundrejt objektivave dhe dimensioneve të Kuadrit të Emirateve të Bashkuara Arabe për Reziliencën Globale ndaj Klimës, duke harmonizuar në këtë mënyrë sistemin kombëtar të monitorimit me objektivin global për përshtatjen.

Tabela 11: Totali i masave dhe kostot për sektor

Sektori	Numri i masave	Kosto (USD)
Ndërsektorial	10	256,721,396.00
Bujqësi	8	678,114,861.00
Pylltari dhe kullota	13	2,134,799,556.00
Turizmi	11	8,491,619.00
Zhvillimi urban	9	2,723,161,544.00
Energjia	8	1,960,573,000.00
Transport	7	2,038,835,000.00
Totali	**66**	**9,800,696,976.00**

Referenca: Plani Kombëtar i Përshtatjes, i Shqipërisë 2026–2036

Shpërndarjet vjetore arrijnë kulmin në vitet 2033–2035 në mbi 1.2 miliardë dollarë amerikanë/vit, duke rënë më pas. Përafërsisht 40% e 66 masave ofrojnë bashkëpërfitime të qarta zbutëse; pylltaria dhe kullotat kontribuojnë me pjesën më të madhe (>60% e bashkëpërfitimeve totale, >300,000 tCO_2e/vit).

6. INFORMACION PËR TË LEHTËSUAR QARTËSINË, TRANSPARENCËN DHE KUPTIMIN E DOKUMENTIT TË PËRDITËSUAR TË KONTRIBUTIT KOMBËTAR TË PËRCAKTUAR TË SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN 2025–2035

Tabela 12: Informacioni për KKP 3.0 sipas shtojcës I, të vendimit 4/KTM.1 (Seanca e parë e Konferencës së palëve që shërben si takimi i palëve në Marrëveshjen e Parisit)

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
1	**Informacion i matshëm sasior nisur nga pika e referencës (duke përfshirë, sipas rastit, një vit bazë) 1(a)**	
1(a)	Viti(vitet) e referencës, viti(vitet) bazë, periudha(t) e referencës ose pikënisja(et) e tjera;	Viti bazë: 1990.
1(b)	Informacion i matshëm sasior nisur nga treguesit e referencës, vlerat e tyre në vitin(vitet) e referencës, vitin(vitet) bazë, periudhën(at) e referencës ose pikënisjen(t) e tjera dhe, sipas rastit, në vitin e synuar;	Treguesi i referencës do të matet duke përdorur nivelet totale kombëtare të raportuara në Raportin e Inventarit Kombëtar të Shqipërisë. Këto vlera mund të përditësohen për të pasqyruar përmirësimet metodologjike në inventarin e gazeve me efekt serrë (GES).
1(c)	Për strategjitë, planet dhe veprimet e përmendura në nenin 4, paragrafi 6, i Marrëveshjes së Parisit ose për politikat dhe masat si komponentë të kontributeve kombëtare të përcaktuara, për të cilat pika 1, germa "b" më sipër nuk zbatohet, palët duhet të sigurojnë informacione të tjera përkatëse;	Nuk zbatohet.
1(d)	Objektivi i lidhur me treguesin e referencës, të jetë i shprehur numerikisht, për shembull në përqindje ose sasi reduktimi;	Të gjitha shkarkimet e GES-ve në nivel kombëtar (duke përfshirë në sektorin e PTNPTP-së) synohen të mbeten nën 9195 $ktCO_2eq$ brenda vitit 2035. Ky objektiv bazohet në skenarin "me masa shtesë" (WAM) të parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) 2025 të Shqipërisë. Ai përfaqëson një kufizim të rritjes së shkarkimeve me 17,4% brenda vitit 2035 krahasuar me nivelet e vitit 1990, periudhë kur shkarkimet e GES-ve ishin 7834,07 $ktCO_2eq$. Krahasuar me KKP-në e mëparshme, e cila përcaktoi një objektiv të pakushtëzuar prej 20.9% reduktim ndaj skenarit të zhvillimit të pandryshuar BaU deri në vitin 2030 (me një kufi prej afërsisht 11,978 $ktCO_2eq$), KKP 3.0 miraton një formulim të bazuar në vitin bazë 1990; krahasimi ndërmjet dy objektivave paraqitet në seksionin 4.2. Arritja e objektivit për zbutjen brenda vitit 2035, si dhe e objektivit të ndërmjetëm të përditësuar për vitin 2030, të parashikuar në PKEK 2025 (shihni seksionin 4.2), do të kërkojë zbatim të plotë dhe financim të përshtatshëm të të gjitha masave për zbutjen të përfshira në PKEK 2025. Kjo do të sigurojë që angazhimet e lidhura me politikat të përkthehen në veprime konkrete, duke i mundësuar Shqipërisë të mbetet në rrugën e duhur drejt objektivave të saj afatgjata të

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
		dekarbonizimit.
1(e)	Informacion mbi burimet e të dhënave të përdorura për kuantifikimin e pikave të referencës;	Shqipëria ka rishikuar formatin e objektivit të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (KKP), duke kaluar nga objektivi njëvjeçar krahasuar me skenarin e punës si zakonisht (BaU) tek një objektiv njëvjeçar krahasuar me një vit bazë. Ky ndryshim e krahason objektivin me një vit historik referencë dhe jo me një vlerë referencë të vlerësuar, duke rritur kështu transparencën, krahasueshmërinë dhe përshtatshmërinë metodologjike. Objektivi i ri përfaqëson një **angazhim më ambicioz** krahasuar me KKP-në e mëparshme të Shqipërisë për vitin 2030. Sipas objektivit të mëparshëm, shkarkimet e GES-ve duhej të reduktoheshin me 20,9% krahasuar me skenarin BaU, duke kufizuar shkarkimet nën 11 978 $ktCO_2eq$ brenda vitit 2030. Në KKP-në e përditësuar, shkarkimet e vitit 2030 synohen të mbeten nën nivelin 10 210 $ktCO_2eq$, çka përkon me kufizimin e rritjes së shkarkimeve me 30,3% mbi nivelet e vitit 1990, në përputhje me PKEK 2025. Treguesi referencë (shkarkimet neto të GES-ve) do të matet duke përdorur të dhënat e raportuara në Raportin e Inventarit Kombëtar të Shqipërisë, i cili dorëzohet së bashku me BTR-në.
1(f)	Informacion mbi rrethanat në të cilat pala mund të përditësojë vlerat e treguesve të referencës.	Inventari i Shqipërisë për GES-të po pëson përmirësime; ndaj, vlerat e raportuara mund të përditësohen për të pasqyruar përmirësimet metodologjike në procesin e inventarit.
2	**Afatet kohore dhe/ose periudhat e zbatimit**	
2(a)	Afati kohor dhe/ose periudha e zbatimit, duke përfshirë datën e fillimit dhe të përfundimit, në përputhje me çdo vendim tjetër përkatës të miratuar nga Konferenca e Palëve që shërben si takimi i palëve në Marrëveshjen e Parisit (CMA);	1 janar 2025 – 31 dhjetor 2035.
2(b)	Nëse është objektiv njëvjeçar apo shumëvjeçar, sipas rastit.	Objektivi njëvjeçar, 2035.
3	**Objekti dhe mbulimi**	
3(a)	Përshkrimi i përgjithshëm i objektivit;	Shqipëria synon t'i mbajë shkarkimet neto të gazeve me efekt serrë (GES) nën 9195 $ktCO_2eq$ brenda vitit 2035. Ky objektiv bazohet në skenarin "me masa shtesë" (WAM) të parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) 2025 të Shqipërisë. Ai pasqyron një kufizim të rritjes së shkarkimeve me 17,4% mbi nivelet e vitit 1990, periudhë kur shkarkimet e GES-ve ishin 7834,07 $ktCO_2eq$. Objektivi shtrihet në mbarë ekonominë dhe mbulon të gjitha shkarkimet e GES-ve në nivel kombëtar, dhe

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
		synohet të arrihet pa u mbështetur te kontributet nga kreditet ndërkombëtare.
3(b)	Sektorët, gazet, kategoritë dhe rezervat janë të mbuluara nga Kontributi Kombëtar i Përcaktuar, duke përfshirë, sipas rastit, pajtueshmërinë me udhëzimet e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK);	Detajet e mëtejshme do të sigurohen sipas udhëzimeve të PNNK-së në Raportet dyvjeçare të transparencës së Shqipërisë. **Sektorët e mbuluar:** - Energjia (me përjashtim të transportit ndërkombëtar); - Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve (PIPP); - Bujqësia; - Mbetjet; - Përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (PTNPTP) (shihni paragrafin 5e për informacion të mëtejshëm mbi këtë sektor). **Gazet:** - Dyoksidi i karbonit (CO_2); - Metani (CH_4); - Oksidi i azotit (N_2O); - HFC-të; - PFC-të, SF_6 dhe NF_3 nuk mbulohen pasi konsiderohen të papërfillshme. Përfshirja e perfluorokarbonëve (PFC-ve), hekzafluorit të squfurit (SF_6) dhe trifluorit të azotit (NF_3) do t'i shtohet mbulimit të KKP-së pasi të përfshihen në inventarin e GES-ve të Shqipërisë. **Mbulimi gjeografik:** I gjithë territori i vendit.
3(c)	Mënyra se si pala i ka marrë në konsideratë paragrafët 31, germat "c" dhe "d", të vendimit 1/CP.21;	KKP-ja e Shqipërisë përfshin mbarë ekonominë dhe rrjedhimisht është përafruar me këtë dispozitë. Janë përfshirë të gjitha kategoritë e burimeve dhe përthithësve, në bazë të inventarit më të fundit kombëtar të GES-ve. Janë vendosur shënime kyçe sipas udhëzimeve të PNNK-së të vitit 2006 (vëllimi 1), si dhe me paragrafët 31 dhe 32, të vendimit 18/KTM.1 mbi modalitetet, procedurat dhe udhëzimet për kuadrin e transparencës për veprimin dhe mbështetjen sipas nenit 13 të Marrëveshjes së Parisit.
3(d)	Përfitimet e përbashkëta prej zbutjes që rezultojnë nga veprimet e palëve për përshtatjen dhe/ose planet e diversifikimit ekonomik, duke përfshirë përshkrimin e projekteve specifike, masave dhe iniciativave të masave të përshtatjes të palëve, dhe/ose planet e diversifikimit ekonomik.	Nuk zbatohet. Përfitimet e përbashkëta të zbutjes që rezultojnë nga veprimet e Shqipërisë për përshtatjen nuk po gjurmohen aktualisht, pasi nuk ka një metodologji të përcaktuar, pavarësisht rëndësisë dhe potencialit të tyre të lartë. Përshtatja mbetet një prioritet kombëtar për shkak të cenueshmërisë së Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimatike, dhe shumë veprime, sidomos në fushat e pylltarisë, mbrojtjes së burimeve ujore, bujqësisë së qëndrueshme dhe diversifikimit të energjisë, janë

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
		harmonizuar me objektivat e zbutjes dhe kontribuojnë në reduktimin e shkarkimeve në sektorët e PPTT-së dhe energjisë.
4	**Proceset e planifikimit**	
4(a)	Informacion lidhur me proceset e planifikimit që ka ndërmarrë pala për të përgatitur kontributin e saj kombëtar të përcaktuar dhe, nëse është e mundur, informacion lidhur me planet e zbatimit të palës, duke përfshirë, sipas rastit:	KKP 3.0 e përditësuar u përgatit përmes një grupi ndërinstitucional pune, me mbështetje teknike të ofruar nga GIZ, duke u mbështetur në PKEK për vitin 2025, PKP dhe Raportin më të fundit Kombëtar të Inventarit. Përgatitja e saj kombinoi analizën teknike me konsultimin me palët e interesuara dhe publikun, ndërsa marrëveshjet institucionale kombëtare dhe procedurat e konsultimit për këtë proces përshkruhen në seksionin 4(a)(i)–(iii) më poshtë.
4(a)i	Marrëveshjet institucionale të brendshme, pjesëmarrjen dhe angazhimin e publikut me komunitetet vendore dhe popullatën autoktone, në një mënyrë që trajton çështjet gjinore;	Meqenëse KKP-ja miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ka një procedurë specifike për miratimin e saj dhe garantimin e pjesëmarrjes së publikut dhe të komuniteteve vendase. Sipas marrëveshjeve institucionale, drafti i KKP-së duhet të qarkullojë në të gjitha ministritë dhe agjencitë përkatëse të linjës, me qëllim që këto të fundit të japin komentet e tyre përpara se drafti të dërgohet në Këshillin e Ministrave për miratimin përfundimtar. Përgatitja e KKP-së bazohet, gjithashtu, në qasjen e përgjegjshme ndaj gjinisë së integruar në PKP, duke siguruar që nevojat e grave dhe të grupeve të tjera në situatë vulnerabiliteti të adresohen gjatë procesit të planifikimit të përshtatjes. Gjithashtu, në përputhje me ligjin nr. 146, datë 30.10.2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik" *Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:* *a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;* *b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji*. Përpara miratimit, projektakti do të publikohet në regjistrin elektronik të projektakteve për komente nga publiku. Komentet e paraqitura nga ministritë e linjës dhe përmes platformës elektronike të Konsultimit Publik shqyrtohen dhe merren në konsideratë

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
		gjatë rishikimit të draftit. Pasi komentet të jenë reflektuar, drafti i përditësuar i ridërgohet ministrive përkatëse të linjës për miratim përfundimtar, i shoqëruar nga një shënim i shkurtër shpjegues që tregon se si është trajtuar secili koment ose pse nuk mund të përfshihej. Pas këtij hapi, dhe pas sigurimit të miratimit përfundimtar ndërinstitucional, drafti i paraqitet zyrtarisht Këshillit të Ministrave për miratim sipas procedurave ligjore kombëtare.
4(a)ii	Çështjet kontekstuale, duke përfshirë, ndër të tjera, sipas rastit: a) Rrethanat kombëtare, të tilla si: gjeografia, klima, ekonomia, zhvillimi i qëndrueshëm dhe çrrënjosja e varfërisë; b) Praktikat dhe përvojat më të mira, në lidhje me përgatitjen e kontributit kombëtar të përcaktuar; c) Aspiratat dhe përparësitë e tjera kontekstuale të pranuara pas pjesëmarrjes në Marrëveshjen e Parisit;	Shqipëria ndodhet në cepin jugperëndimor të Gadishullit të Ballkanit dhe zë një sipërfaqe prej 28 748 kilometra katrorë, me një gjatësi maksimale prej rreth 340 km dhe gjerësi maksimale prej rreth 150 km. Pjesa më e madhe e vendit ka terren të thyer dhe malor. Maja më e lartë është Korabi, në zonën verilindore, me lartësi 2752 m. Shqipëria ka një vijë kufitare me gjatësi 1094 km, 30% e së cilës përbëhet nga bregdeti i detit Adriatik dhe detit Jon, si dhe nga disa liqene ndërkufitare, ndër të cilët vlen të përmendet liqeni i Shkodrës (më i madhi në Ballkan) dhe liqeni i Ohrit (më i thelli). Popullsia në Republikën e Shqipërisë, sipas censit të vitit 2023, ishte 2 402 113 banorë, një rënie me 420 000 banorë krahasuar me censin e vitit 2011. Dendësia e popullsisë së Shqipërisë është 83,6 banorë për kilometër katror dhe rënia e popullsisë ndjek tendencën e vëzhguar që nga viti 1990 që vjen si pasojë e fenomenit të emigracionit. **Konteksti politik** Shqipëria aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), në prill të vitit 2009 dhe që nga qershori i vitit 2014 është vend zyrtar kandidat për anëtarësim. Anëtarësimi në BE është një objektiv kryesor politik dhe strategjik, i cili formëson zhvillimin ligjor, ekonomik dhe institucional të Shqipërisë. Më 25 mars 2022, Këshilli i BE-së vendosi të hapë negociatat për anëtarësim, vendim ky i cili u miratua nga Këshilli Evropian ditën pasuese (26 mars 2022). Shqipëria ka bërë progres të qëndrueshëm në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE. Integrimi në BE mbetet një prioritet kryesor i qeverisë shqiptare dhe procesi i negociatave shihet si një faktor nxitës thelbësor për avancimin e reformave që lidhen me BE-në sipas metodologjisë së rishikuar. Shqipëria miratoi pozicionin negociues për grupkapitullin 4 dhe e dorëzoi atë zyrtarisht në KE, në qershor të vitit 2025. Negociatat për grupkapitullin 4 u hapën zyrtarisht më 16 shtator 2025, pas Konferencës së 6-të Ndërqeveritare me Shqipërinë. Ndryshimet mjedisore dhe klimatike janë, gjithashtu, në fokus të qeverisë së re së formuar

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
		nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025. Në programin e qeverisë, një nga angazhimet për sektorin është: "të harmonizohen politikat klimatike në të gjithë sektorët për të reduktuar shkarkimet dhe për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike.". Bashkëpunimi rajonal sipas Procesit të Berlinit dhe miratimi nga ana e Shqipërisë i Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor kanë forcuar më tej angazhimin e saj për një të ardhme neutrale ndaj karbonit, brenda vitit 2050. Shqipëria është e angazhuar në zbatimin e Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër dhe është përfshirë, gjithashtu, në mënyrë aktive, në përditësimin më të fundit të këtij plani. Shqipëria është palë në pjesën më të madhe të marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe, duke përfshirë në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike që nga viti 1994, si dhe ka ratifikuar Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshjen e Parisit, përkatësisht në vitet 2005 dhe 2016. Shqipëria ka qenë anëtare aktive në Konferencën e Palëve, si dhe po punon drejt përmbushjes së angazhimeve. **Konteksti ekonomik** Ekonomia e Shqipërisë ka regjistruar rritje të qëndrueshme. Në vitin 2024, rritja ishte 4% ndërsa projeksionet për vitet e ardhshme janë disi më të ulëta, por megjithatë pozitive (rreth 3–3,5%). Ekonomia dominohet nga sektori i shërbimeve, ndërsa sektorët kyç janë turizmi, tregtia, transporti dhe pasuritë e paluajtshme. Vlen të theksohet se bujqësia mbetet e rëndësishme, sidomos për punësimin, por kontributi i saj relativ është në rënie. Deficiti ka njohur luhatje; borxhi publik është në nivele mesatare, rreth 55–60% e PBB-së në vitet e fundit (INSTAT, 2025). Zbatimi i politikave të Shqipërisë për klimën dhe energjinë pritet të sjellë përfitime të konsiderueshme ekonomike. Investimet në burimet e rinovueshme, eficiencën e energjisë dhe teknologjitë e gjelbra, do të kontribuojnë në rritjen e PBB-së, në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në reduktimin e varësisë nga importet e energjisë, duke përmirësuar stabilitetin makroekonomik. Sektorët si ndërtimi, prodhimi dhe teknologjia pritet të zgjerohen për shkak të rritjes së kërkesës për ndërtesat me eficiencë energjie dhe për infrastrukturën e energjisë së rinovueshme. Tranzicioni i gjelbër do të stimulojë, gjithashtu, novacionin dhe zhvillimin e tregjeve të reja, duke mbështetur njëkohësisht qëndrueshmërinë përmes

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
		rritjes së të ardhurave nga tatimet dhe uljes së subvencioneve. **Konteksti mjedisor** Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat parësorë të vendit. Mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e natyrës njihen si vlera themelore kushtetuese, të cilat çdo individ ka përgjegjësinë t'i mbrojë dhe përmirësojë. Që nga viti 2002, vendi ka filluar procesin e harmonizimit të legjislacionit mjedisor me legjislacionin e BE-së dhe janë miratuar ligje të reja për mjedisin, mbrojtjen e natyrës, burimet ujore, cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve. Ka ligje specifike që rregullojnë procesin e VNM-së, VSM-së, si dhe për kontrollin e integruar të ndotjes (KIN), menaxhimin e rrezikut dhe kimikatet. Ndonëse Shqipëria mund të konsiderohet si një vend që ka hedhur themelet për progres mjedisor dhe mbrojtje të mjedisit, sfida më e madhe është zbatimi i legjislacionit, lidhur me menaxhimin e ujërave dhe të mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, energjinë, ndotjen industriale, menaxhimin e rrezikut, si dhe me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Për më tepër, kapacitetet administrative janë të pamjaftueshme në nivel qendror dhe vendor, sidomos për sa i përket kualifikimeve dhe burimeve njerëzore në dispozicion për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin, energjinë dhe ndryshimet klimatike. **Konteksti i politikave për klimën dhe energjinë** Politikat kombëtare për klimën dhe energjinë luajnë një rol qendror në adresimin e sfidave mjedisore, duke u fokusuar në reduktimin e GES-ve, në zgjerimin e energjisë së rinovueshme dhe në eficiencën e energjisë. Këto masa shoqërohen me përpjekjet në bujqësi, transport dhe ruajtjen e biodiversitetit. Shqipëria synon të ekuilibrojë zhvillimin e energjisë me mbrojtjen e ekosistemit përmes integrimit të aspekteve të ndikimit në mjedis në planifikimin e infrastrukturës. Veprimet për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike mbështesin shëndetin e tokës, bujqësinë, biodiversitetin dhe restaurimin e habitateve natyrore. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Parisit nga qeveria (Nju Jork, 22 prill 2016), Shqipëria hyri në një epokë të re në procesin e politikave ndërkombëtare për klimën, në të cilën të gjitha palët synojnë bashkërisht ta kufizojnë rritjen globale të temperaturës deri në 2°C mbi nivelet

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
		paraindustriale. Strategjia Kombëtare e Energjisë, PKEK-ja për periudhën 2020–2030, Plani i Veprimit për Zbutjen, si pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, Plani Kombëtar për Zbutjen e GES-ve dhe Strategjia e Transportit, kanë përcaktuar objektiva dhe pikësynime për rritjen e sigurisë së furnizimit me anë të investimeve në sektorin e energjisë elektrike, penetrimit të gazit në tregun shqiptar dhe rritjes së përqindjes së BRE-ve dhe eficiencës së energjisë, pasuar nga një reduktim i shkarkimit të GES-ve. Pjesëmarrja e sektorit privat do të luajë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zbatimit të KKP-së, veçanërisht përmes investimeve në energjinë e rinovueshme, eficiencën e energjisë dhe nismat klimatike të bazuara në mekanizmat e tregut, përfshirë ankandet konkurruese për energjinë e rinovueshme. **Konteksti social** Politikat për klimën dhe energjinë janë projektuar për të qenë gjithëpërfshirëse nga ana sociale, duke synuar përmirësimin e mirëqenies, kapitalit dhe aksesit në burimet e energjisë, veçanërisht për popullatat e cenueshme. Investimet e gjelbra në ndërtim dhe në burimet e rinovueshme kanë çuar në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në rritjen e të ardhurave, duke kontribuuar në uljen e varfërisë dhe në zhvillimin social. Pjesëmarrja publike dhe angazhimi i grupeve të interesit janë nënvizuar si elemente të rëndësishme për të garantuar tranzicione transparente dhe të pranueshme nga ana sociale. Programet e edukimit dhe të ndërgjegjësimit promovojnë më tej menaxhimin e kujdesshëm mjedisor dhe fuqizojnë komunitetet për të mbështetur veprimet për klimën. Kur është e nevojshme, aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit, edukimin dhe angazhimin e palëve të interesuara mbështeten përmes programeve dhe nismave kombëtare ekzistuese. Në mënyrë të veçantë, objektivat kombëtarë lidhur me eficiencën e energjisë kanë për qëllim reduktimin e konsumit të energjisë për njësi, duke kontribuar kështu në furnizimin me energji të përballueshme dhe reduktimin e varfërisë. Plani synon të balancojë objektivat mjedisorë me mirëqenien sociale, duke përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët.
4(b)	Informacioni specifik i zbatueshëm për palët, duke përfshirë organizatat rajonale të integrimit ekonomik dhe shtetet e tyre anëtare, që kanë arritur një marrëveshje për	Objektivi i përditësuar i KKP-së do të përmbushet nga Shqipëria dhe nuk është pjesë e marrëveshjes së përbashkët rajonale.

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
	të vepruar së bashku sipas nenit 4, paragrafi 2, të Marrëveshjes së Parisit, përfshirë palët që kanë rënë dakord të veprojnë bashkërisht dhe kushtet e marrëveshjes, në përputhje me nenin 4, paragrafët 16–18, të Marrëveshjes së Parisit;	
4(c)	Në cilat informacione është mbështetur pala për të përgatitur KKP-në e saj nga tërësia e inventarit global, në përputhje me nenin 4, paragrafi 9, të Marrëveshjes së Parisit;	KKP 3.0 është më ambicioz se KKP-ja e mëparshme. Për më tepër, Shqipëria po punon, gjithashtu, drejt neutralitetit klimatik brenda vitit 2050, siç nënvizohet në Planin e saj Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK).
4(d)	Secila palë me një KKP sipas nenit 4 të Marrëveshjes së Parisit që konsiston në veprime për përshtatjen dhe/ose plane të diversifikimit ekonomik të cilat rezultojnë në përfitime të përbashkëta të zbutjes në përputhje me nenin 4, paragrafi 7, të Marrëveshjes së Parisit paraqet informacione në lidhje me: i. Mënyrën se si janë marrë në konsideratë pasojat ekonomike dhe sociale të masave të përgjigjes në zhvillimin e KKP-së; ii. Projekte, masa dhe aktivitete specifike që do të zbatohen për të kontribuar në përfitimet e përbashkëta të zbutjes, duke përfshirë informacionin mbi planet e përshtatjes që gjithashtu japin përfitime të zbutjes, të cilat mund të mbulojnë, por nuk kufizohen me, sektorët kryesorë, siç janë burimet e energjisë, burimet ujore, burimet bregdetare, vendbanimet dhe planifikimi urban, bujqësia dhe pyjet; dhe masat e diversifikimit ekonomik, të cilat mund të mbulojnë, por nuk kufizohen me sektorë të tillë si prodhimi dhe industria, energjia dhe minierat, transporti dhe komunikimi, ndërtimi, turizmi, pasuritë e paluajtshme, bujqësia dhe peshkimi.	Nuk zbatohet (referojuni paragrafit 3d).
5	**Supozimet dhe qasjet metodologjike, duke përfshirë ato për vlerësimin dhe llogaritjen e shkarkimeve antropogjene të gazeve me efekt serrë dhe, sipas rastit, përthithjet**	
5(a)	Supozimet dhe qasjet metodologjike të përdorura për llogaritjen e shkarkimeve antropogjene të gazeve me efekt serrë dhe përthithjet e tyre që korrespondojnë me kontributet kombëtare të përcaktuara të palës, në përputhje me vendimin 1/CP.21, paragrafi 31 dhe udhëzimin e llogaritjes së miratuar nga KTM-ja;	Qasja aktuale e Shqipërisë për llogaritjen është në përputhje me metodologjitë dhe parametrat e përbashkët të parashikuar nga PNNK-ja (shihni paragrafin 5(d) më poshtë). Vendi ka përditësuar inventarin e tij për shkarkimin e GES-ve dhe ka kryer rillogaritje për të përmirësuar cilësinë dhe besueshmërinë e vlerësimeve në BTR-në e parë. Janë zbatuar metodologji të qëndrueshme gjatë të gjithë periudhës së raportimit (1990–2022). Për sa i përket llogaritjes së shkarkimeve antropogjene dhe përthithjeve, është ndjekur udhëzimi i paraqitur në shtojcën II, të vendimit 4/KTM.1.
5(b)	Supozimet dhe qasjet metodologjike të	Nuk aplikohet. KKP-ja e Shqipërisë përbën një

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
	përdorura për llogaritjen e zbatimit të politikave dhe masave ose strategjive në kontributin kombëtar të përcaktuar;	kufizim absolut në mbarë ekonominë të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.
5(c)	Nëse është e zbatueshme, informacioni se si pala do të marrë parasysh metodat dhe udhëzimet ekzistuese sipas Konventës për të llogaritur shkarkimet antropogjene dhe përthithjet, në përputhje me nenin 4, paragrafi 14, të Marrëveshjes së Parisit, sipas rastit.	Shihni paragrafin 5(d) më poshtë.
5(d)	Metodologjitë dhe parametrat e PNNK-së të përdorura për vlerësimin e shkarkimeve antropogjene të gazeve me efekt serrë dhe të përthithjeve.	Metodologjitë: Udhëzimet e PNNK-së për Inventarët Kombëtarë të Gazrave Serrë, në përputhje me seksionin 4, 2006. Parametrat: Potenciali i Ngrohjes Globale për një interval kohor prej 100 vjetësh, në përputhje me Raportin e 5-të të vlerësimit të PNNK-së.
5(e)	Supozimet, metodologjitë dhe qasjet specifike për sektorin, kategorinë ose aktivitetin, në përputhje me udhëzimet e PNNK-së, duke përfshirë, sipas rastit: i. Qasjen për adresimin e shkarkimeve dhe përthithjen e tyre nga interferimi në natyrën e tokave të menaxhuara; ii. Qasjen e përdorur për të llogaritur shkarkimet dhe përthithjet nga produktet e vjela të drurit (PVD); iii. Qasjen e përdorur për të trajtuar efektet e strukturës moshore në pyje;	Qasjet e mëposhtme (i)–(iii) zbatohen për të gjithë sektorin e Përdorimit të Tokës, Ndryshimit të Përdorimit të Tokës dhe Pylltarisë (LULUCF/AFOLU), në përputhje me Udhëzuesit e PNNK-së të vitit 2006 për Inventarët Kombëtarë të Gazeve me Efekt Serë, vëllimi 4 (bujqësia, pylltaria dhe përdorime të tjera të tokës). i. Interferimet në natyrë llogariten në inventar dhe në llogaritjen e projeksioneve për KKP-në. Zjarret në pyje janë të vetmet interferime (shqetësime) të marra në konsideratë dhe nuk përjashtohen nga totali i shkarkimeve në PPTT. Për projeksionet, përdoret një nivel bazë shkarkimesh (me përjashtim të episodeve të jashtëzakonshme), pasi episodet e jashtëzakonshme nuk mund të parashikohen; ii. PVD-të nuk janë llogaritur ende në inventarin kombëtar, por zbatohet supozimi i oksidimit të menjëhershëm. E njëjta gjë është bërë në KKP për të qenë konsistentë. Inventarët e ardhshëm do të konsiderojnë nëse mund të përmirësohet llogaritja e PVD-ve; iii. Nuk është aplikuar asnjë modelim specifik i biomasës pyjore. Projeksioni bazohet në parametrat (shkalla e rritjes, humbjet) e përdorura në inventar.
5(f)	Supozimet dhe qasjet e tjera metodologjike të përdorura për të kuptuar kontributin kombëtar të përcaktuar dhe, nëse është e zbatueshme, për të vlerësuar shkarkimet dhe përthithjet përkatëse, duke përfshirë: i. Mënyrën si ndërtohen treguesit e referencës, nivel(et) bazë dhe/ose niveli(et) e referencës, duke përfshirë, sipas rastit,	i. Monitorimi i KKP-së bazohet në shkarkimet e GES-ve të raportuara në raportet dyvjeçare të transparencës (BTR), të vlerësuara në përputhje me Udhëzimet e PNNK-së 2006 për Inventarët Kombëtarë të Gazeve me Efekt Serrë. Dokumenti i Inventarit Kombëtar (DIK), i cili është pjesë e BTR-ve, ofron informacion të detajuar mbi vlerësimin e shkarkimeve të GES-ve. Zbatimi i KKP-së do të mbështetet nga kuadri kombëtar i

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
	nivelet e referencës - specifike të sektorit, kategorisë ose aktivitetit, duke përfshirë, për shembull, parametrat kryesorë, supozimet, përkufizimet, metodologjitë, burimet e të dhënave dhe modelet e përdorura; ii. Për palët me kontribute kombëtare të përcaktuara që përmbajnë komponentë jo të gazeve serrë, informacion mbi supozimet dhe qasjet metodologjike të përdorura, në lidhje me ato komponentë, sipas rastit; iii. Për sforcuesit e klimës të përfshirë në kontributet kombëtare të përcaktuara që nuk mbulohen nga udhëzimet e PNNK-së, informacion mbi mënyrën se si vlerësohen sforcuesit e klimës; iv. Informacione të mëtejshme teknike, sipas nevojës;	MRV-së (Monitorimit, Raportimit dhe Verifikimit) i Shqipërisë, i përcaktuar në bazë të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar. Ligji përcakton përgjegjësitë institucionale për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë, si dhe të progresit drejt objektivave kombëtarë klimatikë, në përputhje me Kuadrin e Përmirësuar të Transparencës sipas Marrëveshjes së Parisit; ii. Nuk aplikohet. KKP-ja e Shqipërisë përbën një objektiv absolut në mbarë ekonominë për shkarkimet e gazeve me efekt serrë; iii. Nuk aplikohet. KKP-ja e Shqipërisë përfshin vetëm sforcuesit që mbulohen nga udhëzimet e PNNK-së; iv. Nuk aplikohet.
5(g)	Synimi për të përdorur bashkëpunimin vullnetar sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Parisit, sipas rastit.	Objektivi i KKP-së duhet të arrihet vetëm përmes masave të brendshme, pa kontribut nga kreditet ndërkombëtare. Shqipëria synon të përdorë bashkëpunimin vullnetar sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Parisit dhe të shesë kreditet e karbonit gjatë periudhës deri në vitin 2035, për të kontribuar në zbatimin me kosto efikase të trajektores së zhvillimit me shkarkime të ulëta dhe zhvillimit të saj të qëndrueshëm. Shqipëria parashikon që përdorimi i mekanizmit të tregut ndërkombëtar kushtëzohet nga vendosja e rregullave efikase të llogaritjes të zhvilluara në kuadër të KKKBNK-së për të garantuar integritetin mjedisor të mekanizmave. Zhvillimi i një Sistemi për Tregtimin e Shkarkimeve (ETS) në të ardhmen, në përputhje me standardet e BE-së, është aktualisht në fazën e planifikimit, dhe synimi është mundësimi i lidhjes potenciale në të ardhmen me ETS-në e BE-së.
6	**Mënyra se si pala e konsideron që dokumenti i saj i KKP-së është i drejtë dhe ambicioz në kuadrin e rrethanave të saj kombëtare**	
6(a)	Mënyra se si pala e konsideron që dokumenti i saj i KKP-së është i drejtë dhe ambicioz në kuadrin e rrethanave të saj kombëtare;	Shqipëria e konsideron dokumentin e saj të përditësuar të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (KKP 3.0) si të drejtë dhe ambicioz duke marrë parasysh rrethanat e saj kombëtare. KKP-ja e përditësuar përfaqëson një progres të qartë nga objektivi i mëparshëm, duke rritur nivelin e ambicies përmes caktimit të një objektivi më të rreptë për zbutjen brenda vitit 2030: kufizimi i shkarkimeve të GES-ve nën 10 210 $ktCO_2eq$, krahasuar me objektivin e mëparshëm me 11 978 $ktCO_2eq$. Kjo përkthehet si kufizim i rritjes së shkarkimeve me 30,3% mbi nivelet e vitit 1990,

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
		pavarësisht shkarkimeve për frymë të vendit (3,5 Mg CO_2eq) të cilat mbeten ndjeshëm më të ulëta se mesatarja e BE-27 (8,4 Mg CO_2eq). KKP-ja përfshin mbarë ekonominë, duke mbuluar të gjitha shkarkimet e GES-ve në nivel kombëtar pa u mbështetur në kreditet ndërkombëtare, si dhe përfshin masa të përmirësuara të përshtatjes. Shqipëria po punon gjithashtu drejt neutralitetit klimatik brenda vitit 2050, siç nënvizohet në Planin e saj Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), si dhe po bën investime strategjike për të rritur përqindjen e energjisë së saj të rinovueshme, duke u mbështetur në bazën e saj të konsoliduar hidroenergjetike dhe duke zgjeruar kapacitetet e energjinë diellore, eolike dhe të biomasës. Për më tepër, vendi po zbaton në mënyrë aktive praktika të qëndrueshme rreth përdorimit të tokës dhe nisma pyllëzimi për të ruajtur dhe përmirësuar përthithjen e karbonit. Arritja e objektivit të KKP-së së përditësuar do të kërkojë investime të konsiderueshme, duke theksuar angazhimin e Shqipërisë drejt një tranzicioni më të drejtë e ambicioz në përputhje me prioritetet dhe kapacitetet e saj të zhvillimit. Objektivat e zbutjes dhe të energjisë të KKP-së lidhen drejtpërdrejt me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 7 (energji e përballueshme dhe e pastër) dhe Objektivin 13 (veprimi për klimën), duke e integruar këtë kontribut në agjendën më të gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë dhe në trajektoren drejt neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Për të ndihmuar në mobilizimin e investimeve të nevojshme, Shqipëria synon gjithashtu të përdorë qasjet bashkëpunuese sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Parisit (siç referohet në tabelën 1), si dhe të ardhurat nga Skema e planifikuar e Tregtimit të Emetimeve, si burime novatore të financimit për klimën.
6(b)	Aspektet e drejtësisë, duke përfshirë reflektimin mbi barazinë;	Referojuni paragrafit 6(a).
6(c)	Mënyra si e ka trajtuar pala nenin 4, paragrafi 3 të Marrëveshjes së Parisit;	KKP 3.0 është më ambicioze se KKP-ja e mëparshme. Referojuni paragrafit 6(a).
6(d)	Mënyra si e ka trajtuar pala nenin 4, paragrafi 4 të Marrëveshjes së Parisit;	KKP 3.0 përbën një objektiv në mbarë ekonominë për reduktimin ose kufizimin e shkarkimeve.
6(e)	Mënyra si e ka trajtuar pala nenin 4, paragrafi 6 të Marrëveshjes së Parisit.	Nuk aplikohet.
7	**Si kontribuon KKP-ja në arritjen e objektivit të Konventës siç përcaktohet në nenin 2 të saj**	
7(a)	Si kontribuon KKP-ja në arritjen e objektivit të Konventës siç përcaktohet në nenin 2 të saj;	Shqipëria po punon drejt objektivit ambicioz të arritjes së neutralitetit klimatik brenda vitit 2050, bazuar në parashikimet e detajuara të PKEK-së.

Paragrafi	Teksti nga shtojca I, e vendimit 4/KTM.1	ICTU-ja e zbatueshme për KKP-në e Shqipërisë
7(b)	Mënyra si kontribuon KKP-ja në lidhje me nenin 2, paragrafi 1, germa "a" dhe nenin 4, paragrafi 1, të Marrëveshjes së Parisit.	Shqipëria e konsideron KKP-në e saj, në përputhje me objektivin e KKKBNK-së dhe me objektivat afatgjatë të KKKBNK-së, të Marrëveshjes së Parisit dhe të BE-së, siç shpjegohet në paragrafët 6(a) dhe 7(a).

7. Referenca

- Plani Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Energjinë dhe Klimën (2025)
- KKP-ja e rishikuar e Shqipërisë (2021)
- Komunikimi i Dytë Kombëtar i Shqipërisë në Konferencën e Palëve në zbatim të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (nëntor 2009)
- Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit (2019)
- Dokumenti "Mbi politikat e sektorit të pyjeve në Shqipëri" (2019–2030)
- Draftdokumenti i Inventarit Kombëtar (DIK) 2024, pjesë e dokumenteve të dorëzuara nga Shqipëria sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) dhe Marrëveshjes së Parisit (dhjetor 2024)
- Komunikimi i katërt Kombëtar i Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike (shtator 2022)
- Drafti i Planit Kombëtar të Përshtatjes i Shqipërisë (2024–2025)
- Plani Kombëtar i Përshtatjes (2026–2036)
- Plani i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike i Bashkisë Përmet 2024–2040 (mars 2024)
- Strategjisë Kombëtare e Shqipërisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 (2023)